A.L.T.R.I

STUDIM

MBI ÇËSHTJET GJYQËSORE PENALE DHE CIVILE ME PALË GAZETARË DHE PËRFAQËSUES TË MEDIAS NË KUADËR TË GARANTIMIT TË NJË POLITIKE TË TOLERANCËS ZERO PËR FRIKËSIMIN DHE SULMET NDAJ GAZETARËVE

Tiranë, 2022

A.L.T.R.I

STUDIM

MBI ÇËSHTJET GJYQËSORE PENALE DHE CIVILE ME PALË GAZETARË DHE PËRFAQËSUES TË MEDIAS NË KUADËR TË GARANTIMIT TË NJË POLITIKE TË TOLERANCËS ZERO PËR FRIKËSIMIN DHE SULMET NDAJ GAZETARËVE

Tiranë, 2022

Ky studim është hartuar në kuadër të grantit të mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).

Norwegian Embassy

PARTNERSALBANIA
FOR CHANGE AND DEVELOPMENT

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtimeve 4

Hyrje 5

I. Metodologjia e mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave mbi çështjet gjyqësore (penale dhe civile) me palë gazetarë dhe/ose përfaqësues të medias 6

II. Përmbledhje ekzekutive 10

III. Kuadri ligjor, standardet ndërkombëtare, raportet ndërkombëtare dhe kombëtare për lirinë e shprehjes dhe të medias 15

III.1 Legjislacioni kombëtar për lirinë e shprehjes dhe të medias 15

III.2 Standardet ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes dhe të medias 18

III.3 Situata aktuale e lirisë së medias në Shqipëri, raportet ndërkombëtare dhe kombëtare 30

IV. Prezantimi i studimit mbi çështjet gjyqësore penale dhe civile me palë gazetarë dhe/ose përfaqësues të medias dhe databaza e historikut të këtyre rasteve 34

IV.1 Të dhëna statistikore mbi çështjet civile dhe penale me palë gazetarë të shqyrtuara nga gjykatat e rretheve gjyqësore për vitet 2020-2021 34

IV.2 Të dhëna statistikore mbi çështjet civile dhe penale me palë gazetarë të shqyrtuara nga Gjykatat e Apelit për vitet 2020-2021 40

IV.3 Krijimi i databazës së historikut të çështjeve (penale dhe civile) me palë gazetarë dhe/ose përfaqësues të medias 47

IV. 4 Analiza e të dhënave të mbledhura nga procesi i intervistimit 50

IV.5 Analizë e vendimeve të gjykatave 53

V. Konkluzione dhe rekomandime 56

Shtojca I. Databaza e anonimizuar 59

Shtojca II. Formati i intervistës me përfaqësues të gjykatave, prokurorive, institucioneve dhe OSHC-ve 97

Bibliografia/referenca 106

LISTA E SHKURTIMEVE

BE	Bashkimi Evropian
ECPMF	Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias
GJDBE	Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian
GjEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KLGJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
MD	Ministria e Drejtësisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
RSH	Republika e Shqipërisë
UGSH	Unioni i Gazetarëve Shqiptar

HYRJE

Liria dhe pluralizmi i medias është një parakusht për mirëfunksionimin dhe ruajtjen e demokracisë së një shteti. Komuniteti ndërkombëtar e ka njohur prej kohësh rolin e rëndësishëm që luajnë gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias në shoqëri dhe se garantimi i sigurisë së gazetarëve është thelbësor për ruajtjen e demokracisë.

Më 10 janar 2022, Komisioni Evropian inicioi një konsultim të hapur publik mbi Aktin e ardhshëm Evropian për Lirinë e Medias[1], një nismë historike e shpallur nga Presidentja e Komisionit Europian, znj.Ursula Von Der Leyen ku në fjalimin e saj për gjendjen e Bashkimit Evropian (2021) do të shprehej se: ***"Informacioni është një e mirë publike***. ***Ne duhet të mbrojmë ata që krijojnë transparencë - gazetarët***[2]." Kjo deklaratë vjen në një kohë kur sulmet e dhunshme, një sërë vrasjesh, kërcënimet në internet dhe abuzimet verbale po i vënë profesionistët e medias nën presion[3].

Vetëm gjatë vitit 2021, një sërë sulmesh kanë ndodhur në disa vende të Evropës. *Demonstrues kundër vaksinimit hynë në studiot e transmetuesit publik të Sllovenisë RTV; një gazetar për La Republica të Italisë u godit me grusht në fytyrë gjatë një proteste kundër kufizimeve të koronavirusit; një gazetar holandez u zgjua nga hedhja e koktejve Molotov në shtëpinë e tij; demonstrues hodhën fishekzjarre dhe dogjën makina në një stacion televiziv qipriot. Vetëm gjatë viteve të fundit, janë vrarë gazetarë në Maltë, Sllovaki, Greqi dhe Holandë.*

Projekti i Reagimit të Shpejtë për Lirinë e Medias[4] zbatuar nga Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias (ECPMF), në gjashtë muajt e parë të vitit 2021 ka dokumentuar rreth *202 shkelje të lirisë* së *medias* në vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendet kandidate.

Ajo që vlen të theksohet është se nuk ka vend të lirë, nuk ka demokraci pa pasur një garantim të gjerë të lirisë së shprehjes, të garantuar nga gjykata të pavarura dhe të paanshme.[5]

Në shoqëritë demokratike kudo ekziston një ndërvarësi e fortë ndërmjet rolit të gjyqësorit dhe atij të gazetarëve dhe mediave. Roli i gjyqësorit është të sigurojë respektimin e ligjit dhe të vendos drejtësinë. Roli i gazetarëve është të evidentojë rastet e keqqeverisjes, korrupsionit, apo ndonjë keqbërje tjetër dhe, si të tillë, të jenë zëri i qytetarëve. Rrjedhimisht, *gjyqësori ka nevojë për gazetarët, dhe këta të fundit kanë nevojë për një sistem gjyqësor të drejtë, i cili nëpërmjet vendimmarrjes së tij, garanton drejtësi.*

---

[1] https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_22_85

[2] https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/SPEECH_21_4701

[3] https://www.politico.eu/article/europe-reputation-media-violence-journalist-murders/

[4] https://www.mfrr.eu/

[5] Jochen Abr.Frowein, "Liria e Shprehjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut", në Monitor/Inf (97) 3, Këshilli i Evropës.

Edhe në Shqipëri, një nga shqetësimet e ngritura në mënyrë të vazhdueshme nga Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës si dhe nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile (kombëtare dhe ndërkombëtare) të tilla si "Unioni i Gazetarëve Shqiptar", "Reporter pa kufij", "BIRN", IREX, Qendra Evropiane për Liri të Medias dhe të Shtypit, Federata Evropiane e Gazetarëve, Freedom House etj, është gjendja e lirisë së shprehjes dhe të medias si dhe rastet e sulmeve ndaj gazetarëve.

Nisur nga sa më sipër, Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (Qendra A.L.T.R.I) ndërmori projektin *"Mbi përmirësimin e mjedisit mediatik për të siguruar një politikë të tolerancës zero për frikësimin dhe sulmet ndaj gazetarëve"* me mbështetjen e 'Programit të shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Qëllimi kryesor i kësaj iniciative është përmirësimi i mjedisit mediatik për të siguruar një politikë të tolerancës zero për frikësimin dhe sulmet kundër gazetarëve. Për realizimin e këtij qëllimi, është hartuar studimi "*Mbi çështjet gjyqësore penale dhe civile me palë gazetarë dhe/ose përfaqësues të medias në kuadër të garantimit të një politike të tolerancës zero për frikësimin dhe sulmet ndaj gazetarëve*". Ky studim nuk synon vetëm mbledhjen e çështjeve gjyqësore (penale dhe civile) me palë gazetarë/përfaqësues të mediave në nivel kombëtar por edhe analizën e ecurisë dhe trajtimit të tyre sipas standardeve evropiane. Objektivat e këtij studimi janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i rasteve gjyqësore civile dhe penale me palë gazetarë dhe/ose përfaqësues të medias si dhe analiza e praktikës gjyqësore me qëllim dhënien e rekomandimeve se si të promovohet dhe garantohet liria e shprehjes;
- Krijimi i praktikës së vazhdueshme për identifikimin dhe vlerësimin e rasteve të lidhura me gazetarët dhe krijimi i baze fillestare të dhënash.

I. METODOLOGJIA E MBLEDHJES, PËRPUNIMIT DHE ANALIZIMIT TË TË DHËNAVE MBI ÇËSHTJET GJYQËSORE (PENALE DHE CIVILE) ME PALË GAZETARË DHE/OSE PËRFAQËSUES TË MEDIAS

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave, përpunimit dhe analizimit të çështjeve gjyqësore (penale dhe civile) kundër gazetarëve është realizuar bazuar në objektivat e studimit të përmendura më sipër. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave bazohet në hapat e mëposhtëm:

- **Punë kërkimore** me qëllim identifikimin e: i) **legjislacionit kombëtar** ku përfshihen nenet përkatëse të Kushtetutës, të Konventave apo marrëveshjeve të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, të cilat lidhen me lirinë e shprehjes dhe të medias si dhe ligjeve relevante; ii) **standardeve ndërkombëtare mbi lirinë e shprehjes dhe medias** (Bashkimit Evropian, Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, OSBE) **si dhe jurisprudencës së GJEDNJ** për lirinë e shprehjes dhe medias; iii) **raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare** të cilat hedhin dritë mbi situatën e medias në vend dhe iv)

informacionit mbi raste konkrete të raportuara në media për sa i përket shpifjes, fyerjes, kanosjes, rrahjes, padive për shpërblim dëmi moral, etj, të ngritura gjatë viteve (2015-2020) kundër gazetarëve.

- **Përcaktimit të institucioneve** që disponojnë të dhëna lidhur me çështjet gjyqësore (penale dhe civile) që lidhen drejtpërdrejtë me veprimtarinë e gazetarëve apo përfaqësuesve të medias. Nga analiza paraprake rezultoi se institucionet ku mund të kërkohej informacion ishin: Ministria e Drejtësisë (MD); 22 Gjykatat e Rretheve Gjyqësore; 6 Gjykatat e Apelit, Gjykata e Lartë dhe Prokuroria e Përgjithshme.
- **Përcaktimi i neneve përkatëse të Kodit Civil dhe Kodit Penal dhe hartimi i tabelave për kërkim informacioni.** Përpara se të fillonte procesi i mbledhjes së të dhënave, u hartuan formatet tabelore mbi informacionet që do t'iu kërkohej institucioneve përgjegjëse. Duke u bazuar në ligjin nr.8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, Urdhrin nr. 250, datë 15.04.2019 "Për miratimin e formateve të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore nga Gjykatat në Republikën e Shqipërisë", udhëzimin nr.4, datë 15.04.2019 "Për plotësimin e të dhënave statistikore", ligjin nr.115/2016 "Për institucionet qeverisëse të sistemit të drejtësisë" dhe zbatimit të dispozitave të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", na rezultoi se nuk mund të kërkohej informacion mbi palët në proces, vendimet e plota të arsyetuara, por mund të kërkonim informacion statistikor sipas neneve të:
  - Kodit Civil (Neni 617 / Publikimet mashtruese ose të pasakta ; Neni 618 / Përgjegjësia e punëdhënësit; Neni 625 / Përgjegjësia për dëmin jopasuror dhe Neni 647/a Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe të masës së dëmit jopasuror) ku u kërkua informacion mbi numrin e çështjeve të pranuara, refuzuara, pushuara, përfunduara, si dhe afatet e përfundimit;
  - Në Kodin Penal[6] vlerësojmë se ka nene që lidhen drejtpërdrejtë me lirinë e shprehjes dhe medias dhe ka nene që lidhen indirekt me ushtrimin e profesionit të gazetarit. Nenet që lidhen drejtpërdrejtë me lirinë e shprehjes dhe medias janë kryesisht: Neni 119 / Fyerja; Neni / 120 Shpifja; Neni 237 / Goditjet për shkak të detyrës, Neni 238 / Kanosja për shkak të detyrës. Nisur nga rastet e publikuara në media por dhe nga veprimtaria e gazetarëve apo përfaqësuesve të tjerë të medias, nenet që lidhen indirekt me lirinë e shprehjes dhe të medias janë: Neni / 84 Kanosja; Neni 89 / Plagosja e lehtë me dashje; Neni 90 / Dëmtime të tjera me dashje; Neni 112 / Dhunim i banesës; Neni 121 / Ndërhyrje të padrejta në jetën private; Neni 121 / a Përndjekja; Neni 122 / Përhapja e sekreteve vetjake; Neni 123 / Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës; Neni 150 / Shkatërrim i pronës; Neni 152 / Shkatërrim i pronës me eksploziv; Neni 235 / Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik; Neni 236 / Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik; Neni 242 / Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik; Neni 242/a Moszbatimi i masave të autoriteteve shtetërore gjatë

[6] https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d

gjendjes së masave të jashtëzakonshme apo gjatë gjendjes së epidemisë; Neni 255 / Pengimi dhe shkelja e fshehtësisë së korrespondencës; Neni 261/ Pengimi në ushtrimin e të drejtës për t'u shprehur, grumbulluar apo manifestuar; Neni 262 / Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme; Neni 267 / Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik; Neni 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike; Neni 293/b Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike dhe Neni 295/a Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete. Për të gjitha nenet e sipërcituara u kërkua, numri i vendimeve të filluara, numri i vendimeve të përfunduara, numri i vendimeve të fajësisë / pafajësisë, numri i vendimeve të pushimit të çështjeve, numri i vendimeve për mos kompetencë, shpejtësinë e gjykimit të procesit gjyqësor (pra kohëzgjatjen). Për të gjykuarit u kërkua: numri i të dënuarve, numri i të pafajshmëve; për të dënuarit u kërkua masa e dënimit (gjobë, burg, dënim alternative).

- Nenet e Kodit të Punës nuk u përfshin qëllimisht si pjesë e këtij studimi duke u nisur nga fakti që ishte e pamundur të vlerësohej vetëm mbi statistika në qoftë se rastet civile apo penale, ishin për shkak të thyerjes së besimit midis punëdhënësve dhe punëmarrësve, mosmarrëveshjeve të punës, prishjes së kontratës së punës, mospagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore nga ana e pronarëve të shoqërive mediatike, vjedhjeve, etj. apo vinin si pasojë e vete censurimit të medias. Kjo për arsye se për të gjykuar mbi rastet, duhet të disponinim tekstet e plota të vendimeve gjyqësore.

❖ Qendra ALTRI **kërkoi nga institucionet e mësipërme, të dhëna mbi çështjet (civile dhe penale) me palë gazetarë, për një periudhë 5 vjeçare**. U kërkua informacion mbi numrin e personave të akuzuar, kohën kur ka filluar procesi gjyqësor; kohën, numrin dhe dispozitivin e vendimit në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë. **Nga 21 Gjykata të Rretheve Gjyqësore (nga 22 në total) dhe 6 Gjykata të Apelit u dërgua informacion vetëm për periudhën 2020-2021 duke qenë se nuk i kishin të arkivuara dosjet dhe identifikimi i çështjeve ishte më i lehtë**[7]. Prokuroria e Përgjithshme nuk iu përgjigj kërkesës për informacion të dërguar nga Qendra ALTRI pavarësisht kërkesës së përsëritur, ndaj informacioni lidhur me procedimet penale ndaj gazetarëve është marrë nëpërmjet procesit të intervistimit si dhe kërkimit në raportet e Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve. **Ndërsa Gjykata e Lartë u shpreh se nga kërkimi i realizuar, rezultonte se nuk kishte asnjë çështje me palë gazetarë** ndërkohë që gjatë kërkimit në faqen e tyre elektronike, ekspertët identifikuan dy çështje të regjistruara të pasqyruara në databazën e historikut të të dhënave.

❖ **Realizimi i intervistave të strukturuara** me përfaqësues nga të gjithë institucionet dhe aktorët relevant që disponojnë të dhëna cilësore dhe sasiore mbi çështjet gjyqësore që lidhen drejtpërdrejtë me veprimtarinë e gazetarëve. Në total u zhvilluan 75 intervista sipas ndarjes si vijon: 1 përfaqësues nga KLGJ, 2 përfaqësues nga Kuvendi i Shqipërisë, 3 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, 16 përfaqësues nga Gjykatat e Rretheve

[7] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk u përfshi në këtë studim pasi të dhënat e dërguara nga kjo gjykatë nuk evidentonin vetëm rastet, ku palë në procese (civile dhe penale) ishin gazetarët apo përfaqësuesit e medias, por ishin të përgjithshme, pra për të gjithë subjektet.

Gjyqësore, 3 përfaqësues nga Gjykatat e Apelit, 4 përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme, 1 përfaqësues nga Gjykata e Lartë, 10 përfaqësues nga OSHC-të dhe 35 gazetarë të intervistuar nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga Unioni i Gazetarëve Shqiptar. Formati i intervistave për çdo grup të synuar gjendet në Shtojcën II të këtij raporti.

- **Përpunimi, analizimi i të dhënave të mbledhura, hartimi i databazës së historikut të të dhënave për çështjet me palë gazetarë dhe /ose përfaqësues të medias (track-rekord) si dhe hartimi i rekomandimeve.** Pasi u mblodhën të dhënat nga institucionet e sipërpërmendura, ato u përpunuan dhe u analizuan si dhe u hartua për herë të parë databaza e historikut të të dhënave për çështjet (penale dhe civile) me palë gazetarë apo përfaqësues të medias, në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Databaza (track rekord) përmban informacion se si ka evoluar një numër i caktuar çështjesh penale dhe civile (78 çështje) nga Prokuroria (nëse është çështje penale) ose nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore (nëse është çështje civile) dhe se si ka vijuar trajtimi në rrugë gjyqësore, pra deri në Gjykatën e Lartë. Në databazë janë pasqyruar 107 çështje të identifikuara me palë gazetarë dhe/apo përfaqësues të medias, por vetëm 78 prej tyre kanë përfunduar në gjykatë si çështje gjyqësore civile dhe penale (29 të tjera nuk janë paraqitur në gjykatë). Bazuar në analizën e të dhënave të historikut për 78 çështje (penale dhe civile), u arrit në vlerësimin se "nëse" dhe "si" trajtimi i këtyre çështjeve gjyqësore mund të ketë ndikuar në frikësimin e gazetarëve dhe/ose auto censurën. Për të pasur një analizë më të plotë dhe të thelluar, ecuria procedurale e çështjeve u analizua sipas legjislacionit në fuqi por edhe standardeve e praktikave më të mira ndërkombëtare. Pas përfundimit të të gjithë hapave të mësipërme, u hartuan "konkluzionet dhe rekomandimet" për të promovuar dhe garantuar lirinë e shprehjes dhe të medias si dhe për të siguruar një politikë të tolerancës zero për frikësimin dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe përfaqësuesve të medias.

Gjatë gjithë procesit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave u mbajtën parasysh: parimet e barazisë, mos-diskriminimit, paanësisë, respektimit të detyrimeve të përcaktuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim është i organizuar në **5 Kapituj** (duke përfshirë këtu metodologjinë dhe përmbledhjen ekzekutive të studimit). **Në Kapitullin III.1 dhe III.2** jepet një pasqyrë e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e lirisë së shprehjes dhe të medias duke përfshirë këtu standardet ndërkombëtare të vendosura nga OSBE, OKB, Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës për të pasur një panoramë të qartë të legjislacionit dhe standardeve kryesore që garantojnë lirinë e shprehjes dhe të medias jo vetëm në Shqipëri por dhe në botë. Në **Kapitullin III.3** vijohet me dhënien e një informacioni mbi situatën e lirisë së shprehjes dhe të medias në Shqipëri duke përmendur disa nga gjetjet kryesore të raporteve më të rëndësishme ndërkombëtare dhe kombëtare në këtë fushë.

Në **Kapitullin IV.1, IV.2 dhe IV.3** prezantohen të dhëna statistikore mbi numrin e çështjeve gjyqësore (civile dhe penale), me palë gazetarë apo përfaqësues të medias gjatë viteve 2020-2021, si edhe krijohet për herë të parë një databazë e historikut të rasteve kundër gazetarëve dhe/apo përfaqësuesve të medias (track-record) duke hedhur dritë mbi mënyrën se si ka evoluar një numër i caktuar çështjesh penale dhe civile në shkallë të ndryshme të gjyqësorit.

Referuar çështjeve penale, **në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore** gjatë vitit 2020 janë regjistruar gjithsej 8 çështje penale (3 të reja dhe 5 të mbartura[8]) dhe gjeografia e tyre është relativisht e kufizuar, përkatësisht në Tiranë, Gjirokastër dhe Lushnje. Çështjet e regjistruara, i përkasin 2 veprave penale të parashikuar nga Kodi Penal, atë të Nenit 119 "Fyerja" dhe Nenit 120 "Shpifja". Për vitin 2020, nga gjykimet e kryera për çështjet penale, rezulton një i dënuar. Edhe gjatë vitit 2021, në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore janë regjistruar gjithsej[9] 8 çështje penale. Gjeografia e tyre është relativisht e kufizuar, përkatësisht në Tiranë, Gjirokastër dhe Fier. Çështjet penale të regjistruara, i përkasin 2 veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal, atë të Nenit 120 "Shpifja" dhe të Nenit 236 "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik". Gjatë vitit 2020 kanë përfunduar[10] 6 çështje nga 8 të regjistruara kurse gjatë vitit 2021 kanë përfunduar 3 çështje nga 8 të regjistruara. Pra, numri i çështjeve penale të përfunduara gjatë vitit 2020 ka qenë më i madh sesa ai gjatë vitit 2021[11].

Referuar çështjeve civile, në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore gjatë vitit 2020 janë regjistruar gjithsej 66 çështje civile (ku 39 janë të reja dhe 27 të mbartura). Të gjitha çështjet janë

[8] "Çështje të mbartuara" quhen ato çështje të cilat në fund të vitit paraardhës (31 Dhjetor) rezultojnë të papërfunduara dhe gjykata i mbart si çështje të vetat në fillim të vitit pasardhës (1 Janar).

[9] "Çështje gjithsej", quhet kolona e cila në statistikat penale, përmbledh totalin e shifrave të çështjeve të mbartura, të ardhura të reja, të ardhura për rigjykim dhe të ardhura pas rihetimit.

[10] "Çështje të përfunduara", quhen ato çështje të cilat në fund të vitit paraardhës (31 Dhjetor) rezultojnë të përfunduara, për të cilat gjykata është shprehur me një vendim.

[11] Këtu është e nevojshme që të bëjmë sqarimin se në Gjykata gjykohen edhe çështje të cilat janë regjistruar në vitet e mëparshme dhe jo domosdoshmërisht gjykimi i tyre ka përfunduar në vitin e regjistrimit të tyre.

të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga analiza e të dhënave arrijmë në përfundimin se dispozita ligjore kryesore ku qytetarët janë bazuar më së shumti për ngritjen e padive të tyre është Neni 617 "Publikimet mashtruese ose të pasakta" dhe Neni 625 "Përgjegjësia për dëmin jo pasuror". Nga 66 çështje civile të regjistruara në vitin 2020, numri i çështjeve të përfunduara është 14 (rreth 21%), ndërkohë 52 (rreth 79%) janë ende në proces shqyrtimi. **Në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore gjatë vitit 2021** janë regjistruar gjithsej 49 çështje civile (ku 9 janë të reja dhe 40 janë çështje të mbartura). Gjeografia e tyre është relativisht e kufizuar, ku numrin e çështjeve civile të regjistruara në shkallë vendi e zë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga analiza e të dhënave arrijmë në përfundimin se dispozita ligjore kryesore ku qytetarët janë bazuar më së shumti për ngritjen e padive të tyre është Neni 617 "Publikimet mashtruese ose të pasakta" dhe Neni 625 "Përgjegjësia për dëmin jo pasuror" të Kodit Civil. Nga 49 çështje civile të regjistruara në vitin 2021, numri i çështjeve të përfunduara është 21 (rreth 43%), ndërkohë 28 (rreth 57%) janë ende në proces shqyrtimi. Numri i çështjeve civile të përfunduara gjatë vitit 2021 ka qenë më i madh sesa ai gjatë vitit 2020. Vlen të theksohet se në afatet e gjykimit të çështjeve penale dhe civile në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore ndikon dhe procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe kalimi i dosjeve nga njëri gjyqtar tek tjetri për rastet e shkarkimeve/largimeve të gjyqtarëve, çka sjell si rrjedhojë dhe vonesa në shqyrtimin e tyre.

Ndërkohë që në 6 Gjykatat e Apelit, gjatë vitit 2020 janë regjistruar gjithsej 9 **çështje penale** dhe gjeografia e tyre është relativisht e kufizuar, përkatësisht në Tiranë, Gjirokastër dhe Vlorë. Çështjet penale të regjistruara i përkasin disa veprave penale të parashikuara në Kodin Penal, si ato të Nenit 119 "Fyerja", Nenit 120 "Shpifja", Nenit 121 "Ndërhyrje të padrejta në jetën private" si dhe Nenit 122 "Përhapja e sekreteve vetjake". Për vitin 2020 nga gjykimet e kryera për çështjet penale nuk rezulton asnjë i dënuar. **Gjatë vitit 2021** është regjistruar gjithsej një çështje penale përkatësisht në Tiranë. Çështja penale e regjistruar i përket veprës penale të parashikuar në Nenin 120 "Shpifja" të Kodit Penal. Me vendim përfundimtar është gjykuar 1 person, i cili është deklaruar i pafajshëm. Gjatë vitit 2020 kanë përfunduar 8 çështje nga 9 të regjistruara, kurse gjatë vitit 2021 ka përfunduar 1 çështje nga 1 e regjistruar. **Gjatë vitit 2020 janë regjistruar gjithsej 12 çështje civile,** përkatësisht në Gjykatën e Apelit Tiranë. Nga analiza e të dhënave arrijmë në përfundimin se dispozitat ligjore kryesore ku qytetarët janë bazuar më së shumti për ngritjen e padive së tyre janë Neni 617 "Publikimet mashtruese ose të pasakta", Neni 618 "Përgjegjësia e punëdhënësit", Neni 625 "Përgjegjësia për dëmin jo pasuror", Neni 640 "Shpërblimi i dëmit" dhe Neni 647/a "Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe të masës së dëmit jo pasuror" të Kodit Civil. **Ndërkohë që gjatë vitit 2021** janë regjistruar gjithsej 22 çështje civile përkatësisht në Gjykatën e Apelit Tiranë. Nga analiza e të dhënave arrijmë në përfundimin se dispozitat ligjore kryesore ku qytetarët janë bazuar më së shumti për ngritjen e padive të tyre janë Neni 617 "Publikimet mashtruese ose të pasakta", Neni 625 "Përgjegjësia për dëmin jo pasuror", Neni 640 "Shpërblimi i dëmit" dhe Neni 647/a "Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe të masës së dëmit jo pasuror" të Kodit Civil. Nga analiza rezulton se kemi një trend rritës për çështjet civile të regjistruara në Gjykatën e Apelit nga 12 çështje të regjistruara gjithsej në vitin 2020, në 22 çështje të regjistruara gjatë 2021 (16 të mbartura dhe 6 të reja). Ndërkohë që nga 12 çështje të regjistruara gjatë

vitit 2020 rezulton se të 12 çështjet janë të përfunduara. Po e njëjta situatë vërehet dhe me numrin e çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2021, ku nga 22 të regjistruara të gjitha janë të përfunduara.

Duke marrë në konsideratë të dhënat statistikore të mësipërme si dhe rastet e raportuara në media (ku publiku është informuar mbi raste të dhunës ndaj gazetarëve apo përfaqësuesve të medias, intimidim, apo goditje për shkak të detyrës, pjesëmarrje në organizime të paligjshme, shpifje, fyerje etj etj), gjatë viteve 2015-2021, në **Kapitullin IV.3 dhe në Shtojcën I janë paraqitur të dhëna për çështje (civile dhe penale) me palë gazetarë apo përfaqësues të medias të cilat kanë lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së gazetarëve dhe lirinë e shprehjes së tyre për të raportuar dhe informuar publikun mbi ngjarje të ndryshme** (në vijim "databaza e historikut të të dhënave"). Kjo databazë e historikut të të dhënave na shpjegon se në cilat afate kohore është gjykuar një çështje penale apo civile në të tre shkallët e gjyqësorit, si dhe mënyrën se si ka përfunduar gjykimi i tyre pasi në të është paraqitur dhe dispozitivi i anonimizuar i vendimeve gjyqësore[12].

Nga përpunimi i të dhënave nga **42 raste të raportuara në media për padi penale ndaj gazetarëve apo përfaqësues të medias** në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre gjatë viteve 2015-2021, rezulton se: i) vetëm 13 çështje (ose 31 %) ishin regjistruar në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore (12 në Tiranë dhe 1 në Fier) si çështje penale; ii) 2 çështje vazhdonin të ishin në hetim (1 ishte regjistruar në Prokurori në vitin 2020 dhe tjetra gjatë vitit 2021); iii) për 2 çështje ishte vendosur pezullimi nga ana e Prokurorisë; iv) për 2 çështje ishte vendosur mosfillimi i procedimit penal. Ndërkohë që nga 13 çështje për të cilat është dhënë vendimi në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, vetëm për 8 prej tyre është bërë ankim në Gjykatat e Apelit dhe vetëm për 2 prej tyre është dhënë vendimi duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Pra, 6 çështje të tjera vazhdojnë të jenë ende në gjykim në Gjykatën e Apelit.

Ndërkohë që sa i përket **çështjeve civile, nga 16 raste të raportuara në media gjatë viteve 2015-2021**, rezultoi se të gjithë rastet e raportuara ishin të regjistruara si çështje civile në Gjykatë. Nga analiza kërkimore si dhe nga informacioni i marrë në të tre shkallët e gjyqësorit kemi identifikuar për qëllim të krijimit të kësaj databaze, **65 çështje civile të regjistruara në Gjykatat me palë gazetarë apo përfaqësues të medias,** në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, përgjatë viteve 2014-2021. Nga këto 65 çështje civile të regjistruara në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, rezulton se për 36 çështje ka përfunduar gjykimi, ndërsa 29 të tjerat janë ende në gjykim. Nga 36 çështje të përfunduara në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, vetëm 17 prej tyre janë ankimuar në Gjykatat e Apelit dhe vetëm për 1 nga këto 17 çështje është dhënë vendim. Për këtë çështje është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë dhe është ende në gjykim. Pra, 16 të tjerat janë ende në gjykim në Gjykatën e Apelit. Rasti në fjalë është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2015 dhe në Gjykatën e Lartë në vitin 2018 dhe ende nuk është shqyrtuar. Pra, kemi një çështje e cila ka kaluar në të tre shkallët e gjykimit në një afat kohor prej 7 vitesh dhe ende nuk ka përfunduar shqyrtimi i saj gjyqësor në Gjykatën e Lartë.

[12] Me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve në proces.

Gjobat e vendosura për çështjet civile të analizuara, variojnë në shumat nga *50.000 lekë – 3.500.000 lekë* duke u shoqëruar kryesisht me detyrimin e të paditurve për të publikuar deklarata përgënjeshtruese apo dhe heqje të lajmeve nga portalet apo dhe ndalimin e publikimit të lajmeve ndaj paditësve. *Për më shumë informacion lutem referojuni pikës III.B të studimit.*

Si konkluzion theksojmë se gjatë hartimit të databazës së historikut të të dhënave me palë gazetarë apo përfaqësues të medias, kemi konstatuar se jo të gjitha rastet e raportuara në media apo raporte kombëtare e ndërkombëtare regjistrohen më pas si çështje gjyqësore pranë Gjykatave. Ato ose thjeshtë denoncohen në media dhe nuk bëhet kallëzim ose pushohen në Prokurori (për çështjet penale) ose nuk paraqiten si çështje civile apo penale në gjykatë.

Në kapitullin IV.4 vijohet me pasqyrimin e rezultateve të intervistave të realizuara me gazetarë[13], përfaqësues të institucioneve[14], përfaqësues të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe të Apelit[15] dhe përfaqësues të OSHC-ve me qëllim vjeljen e perceptimit të tyre mbi garantimin e lirisë së medias në Shqipëri por dhe për të kuptuar se cilat janë arsyet që frenojnë gazetarët dhe përfaqësuesit e medias për të ngritur çështje civile apo penale pranë gjykatave, me qëllim garantimin e lirisë së shprehjes dhe të medias. Nga analiza e të dhënave të mbledhura rezulton se gjatë viteve 2015-2021, kemi një rritje të rasteve me palë "gazetarë kundër gazetarëve", "politikanë kundër gazetarëve", "përfaqësues të biznesit kundër gazetarëve", "policia e shtetit kundër gazetarëve" dhe "zyrtarë kundër gazetarëve".

Ajo çka bie në sy është fakti se ndër elementët që ndikojnë më negativisht sa i përket mos ngritjes së padive në gjykatë nga ana e gazetarëve, janë si vijon:

- 63 % e të intervistuarve shprehen se të gjithë elementët si: kohëzgjatja e proceseve gjyqësore, pagesa për shërbime avokatore, tarifa për ngritjen e padisë, statusi i personave ndaj të cilëve mund të ngrihet padia (politikanë, zyrtarë të fuqishëm, biznesmenë të fuqishëm, njerëz të rrezikshëm nga bota e krimit, etj), gjyqtarët dhe praktika gjyqësore, ndikojnë negativisht sa i përket mos ngritjes së padive në gjykatë nga ana e gazetarëve;
- 14 % zgjodhën vetëm pozitën e personave ndaj të cilëve ngrihej padia (politikanë, zyrtarë të fuqishëm, biznesmenë të fuqishëm, njerëz të rrezikshëm nga bota e krimit, etj);
- 13 % zgjodhën vetëm kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore;
- 10 % zgjodhën vetëm gjyqtarët dhe praktikën gjyqësore.

79 % e të intervistuarve shpreheshin që legjislacioni kombëtar dhe standardet ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes së medias nuk zbatoheshin si duhet nga ana e gjykatave, ndërsa 21 % e tyre mendonin që legjislacioni kombëtar dhe standardet ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes së medias zbatoheshin si duhet nga ana e gjykatave.

---

[13] 35 gazetarë të intervistuar;

[14] MD (3 intervista); KLGJ (1 të intervistuar); Kuvendi i R.SH (2 intervista); Prokuroria e Përgjithshme (4 të intervistuar);

[15] 16 intervista në 8 Gjykata të Rretheve Gjyqësore dhe 3 intervista në 3 Gjykata të Apelit;

Në kapitullin IV.5 analizohet praktika gjyqësore dhe të dhënat e historikut të çështjeve me palë gazetarë dhe përfaqësues të medias (analizimi i 30 vendimeve penale dhe civile). Në rastet e vendimeve gjyqësore të cilat vendosin "rrëzimin e padisë", "kthimin e kërkesë padisë", "kthimin e akteve" apo "pushimin e çështjes" nuk kemi ndonjë referencë sa i përket legjislacionit ndërkombëtar apo standardeve ndërkombëtare për lirinë e shprehjes dhe të medias, por referohemi tek legjislacioni i brendshëm. Në rastet e "pranimit të padive" apo "pranimit të pjesshëm të tyre" disa gjyqtarë i janë referuar standardeve ndërkombëtare në arsyetimin e vendimeve gjyqësore (kryesisht vendimeve të GJEDNJ). Gjobat e vendosura nga këto vendime variojnë nga 50.000 lekë deri në 3.500.000 lekë. Në të gjitha vendimet gjyqësore të "pranimit të padisë" dhe "pranimit të pjesshëm të padisë" është vendosur detyrimi i të padituri për të përgënjeshtruar lajmet për paditësin apo dhe heqjen e këtyre lajmeve nga portalet.

Në **kapitullin V jepen disa konkluzione dhe rekomandime** me qëllim përmirësimin e situatës për garantimin e lirisë së shprehjes dhe të medias në Shqipëri.

III. KUADRI LIGJOR, STANDARDET NDËRKOMBËTARE, RAPORTET NDËRKOMBËTARE DHE KOMBËTARE PËR LIRINË E SHPREHJES DHE TË MEDIAS

Për të pasur një kuadër sa më të qartë të fushës së lirisë së shprehjes dhe të medias është e rëndësishme që të njihen: i) kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar përkatës; ii) standardet ndërkombëtare të vendosura nga OSBE, OKB, Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës dhe iii) disa nga gjetjet kryesore të raporteve më të rëndësishme ndërkombëtare dhe kombëtare në këtë fushë të cilat hedhin dritë mbi situatën e lirisë së shprehjes së medias në Shqipëri.

III.1 LEGJISLACIONI KOMBËTAR PËR LIRINË E SHPREHJES DHE TË MEDIAS

Liria e shprehjes është një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut mbi të cilat ngrihet vetë ekzistenca e një shoqërie demokratike dhe garanti i kësaj të drejte është pikërisht sistemi gjyqësor.

Liria e shprehjes është sanksionuar në Kushtetutën e Shqipërisë[16], e cila gjithashtu ka të parashikuar qartë se "*liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar*[17]*" dhe se "censura e mjeteve të komunikimit ndalohet*"[18]. Në nenin 15 të Kushtetutës sanksionohet se "*të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik*". Ndërkohë që organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Ndërsa në nenin 17, Kushtetuta sanksionon se "*kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve por kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë. Gjithashtu, këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut*". ***Pra, maksimumi i kufizimit që mund ti bëhen lirive dhe të drejtave të njeriut në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.***

Gjithashtu në nenin 122, pika 2 dhe 3, të Kushtetutës së Shqipërisë sanksionohet se "*marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara qëndrojnë sipas hierarkisë së akteve, pas*

[16] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 22/1, https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/kushtetuta.pdf

[17] Po aty, Neni 22/2;

[18] Po aty, Neni 22/3;

kushtetutës si akti ligjor më i lartë në Republikën e Shqipërisë dhe mbi çdo ligj tjetër të miratuar në territorin e Republikës së Shqipërisë." Kjo do të thotë se dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore (në vijim KEDNJ) është një Konventë e ratifikuar[19] dhe ajo qëndron mbi aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë. Lidhur me fuqinë juridike të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GjEDNJ) në sistemin tonë juridik, i referohemi dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e cila në Vendimin Nr. 20, datë 01.06.2011 ndër të tjera ka theksuar se "*me rastin e ratifikimit të KEDNJ-së Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si përfaqësues i sovranitetit popullor, ka marrë përsipër detyrime të cilat janë të zbatueshme nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve, pavarësisht llojit të tyre. Për sa më sipër, detyrimet që mbartin secili nga pushtetet për zbatimin e vendimeve përfundimtare të GjEDNj-së janë të ndryshme. Nëse për ekzekutivin janë menjëherë të ravijëzueshme këto detyrime, si p.sh. në rastin e pagimit të dëmshpërblimeve të imponuara nga GjEDNj-ja, për sa i përket dy pushteteve të tjera ka vend për interpretim.* Posaçërisht, për sa i përket vendimeve të GjEDNj-së për procedimet penale, për legjislativin lind nevoja që të marrë masa për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me dispozitat e KEDNJ-së. Nëse nuk ka harmonizim, pra, nëse jemi në rastet e vakumit legjislativ ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli duhet të zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GjEDNj -së në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46 të KEDNJ-së. *Neni 122 i Kushtetutës përcakton shprehimisht se "dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të*"[20]. GjEDNj-ja ka sqaruar parimet që rregullojnë zbatimin e vendimeve të saj, duke i vënë theksin zbatimit efektiv të këtyre vendimeve[21]. Sipas kërkesave të nenit 46 të KEDNJ-së, një shtet palë për të cilin GjEDNj-ja është shprehur se ka shkelur Konventën ose Protokollet e saj, ka detyrimin që të veprojë në përputhje me vendimin e asaj Gjykate.

Sa më sipër, theksojmë se shteti ynë ka një detyrim pozitiv sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të favorshëm, në të cilin të gjithë mund të marrin pjesë në debatin publik pa frikë.

Shqipëria gjithashtu ka aderuar në një sërë Konventash Ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, në kuadër të anëtarësimit të vendit tonë në Kombet e Bashkuara dhe Këshillin e Evropës, por dhe në kuadër të procesit të Integrimit Evropian.

Kështu, në bazë të ***Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore***, në nenin 10 sanksionohet se "*Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë.... Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike,*

---

[19] Ligji nr. 8137, datë 31 korrik 1996, i ndryshuar https://www.gjk.gov.al/web/konventa_europiane_per_te_drejtat_e_njeriut_2130.pdf

[20] Në Vendimin Nr. 45, datë 01.11.2013, Gjykata Kushtetuese lidhur me fuqinë juridike të GjEDNj-së ndër të tjera ka theksuar se "*Vendimet e GjEDNj-së kanë vlerën e tyre në dy aspekte, që lidhen me natyrën detyruese, që rrjedh nga nenet 1 dhe 46 të Konventës, dhe me mënyrën e zbatimit të tyre në sistemin e brendshëm*".

[21] Vendimi në çështjen Verein Gegen Tierfabriken Schëeiz (VgT) kundër Zvicrës (nr. 2), datë 30.06.2009

në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor".

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut[22] në nenin 19 të saj sanksionon se "*Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë".*

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike[23] (neni 19) sanksionon mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe lirisë së shprehjes.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit[24] në nenin 2 të saj sanksionon se "*Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut***,** në Aktin Final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Evropë të re, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, ato të shtetit të së drejtës si edhe për parimet e ekonomisë së tregut, siç pasqyrohen në Dokumentin e Konferencës së Bonit të KSBE-së për Bashkëpunimin Ekonomik, *formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të Palëve dhe përbëjnë elementët thelbësorë të kësaj Marrëveshjeje*". Ndërkohë që nenet 102-104 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit parashikojnë detyrimin për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me acquis të BE-së dhe harmonizimin me politikat e BE-së, në fushën audio-vizuale, në fushën e shoqërisë së informacionit dhe bashkëpunimit që fokusohet në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

Dispozita ligjore që lidhen me median gjenden edhe në Kodin Civil, Kodin Penal edhe në Kodin Zgjedhor. Dispozitat e Kodit Civil dhe Kodit Penal i kemi evidentuar në Metodologjinë e këtij studimi. Ndërkohë në Kodin Zgjedhor[25], nenet që lidhen me lirinë e shprehjes dhe medias janë ato që përcaktojnë mbulimin e fushatës zgjedhore nga nenet 77-85/1 "Fushata zgjedhore dhe media".

Përveç legjislacionit të mësipërm, janë miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore të lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale, informimin, komunikimin elektronik dhe median si më poshtë:

Ligji për shtypin (1993), i ndryshuar, në nenin 1 sanksionon se "*Shtypi është i lirë. Liria e shtypit mbrohet me ligj".*

---

[22] Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948, https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights

[23] Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 19 dhjetor 1966, https://treaties.un.org/doc/publication/unts/volume%20999/volume-999-i-14668-english.pdf

[24] Ligj nr. 9590, datë 27.07.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare" http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/61-marreveshja-e-stabilizim-asociimit

[25] Ligj nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Kodi-Zgjedhor-2020_perditesuar_qpz.pdf

Ligji për komunikimet elektronike (2008), i ndryshuar, i cili ka për qëllim që nëpërmjet parimit të asnjanësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturën efiçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale (2008), i ndryshuar, i cili ka për objekt përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale. Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Ligji për mediat audiovizive (2013), i ndryshuar, i cili rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjanësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ligji për të drejtën e informimit (2014), i cili përcakton se rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë.

Në datën 31 Mars 2022 është miratuar **ligji nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik"**[26] , i cili përcakton bazën ligjore për promovimin e përdorimit të të dhënave të hapura në Republikën e Shqipërisë me qëllim nxitjen e inovacionit në ofrimin e produkteve dhe të shërbimeve, si dhe rregullat për të drejtën e ripërdorimit për qëllime fitimi ose jo të dokumenteve që mbahen nga organet e sektorit publik ose sipërmarrjet publike.

Duhet theksuar se deri më sot, kuadri ligjor shqiptar nuk ka ndonjë dispozitë mbi lirinë e shprehjes online apo mbi organet mediatike.[27]

III.2 STANDARDET NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E LIRISË SË SHPREHJES DHE TË MEDIAS

Sa i përket standardeve ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes dhe medias kemi disa të tilla të përcaktuara, ku më kryesoret përmendim standardet nga: Bashkimi Evropian (BE), Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), Këshilli i Evropës dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

III.2.1 Standardet e Bashkimit Evropian

Referuar standardeve të përcaktuara të Bashkimit Evropian, përveç atyre të Këshillit të Evropës të cilat janë të pranuara nga BE si pjesë e legjislacionit të BE-së, vlen të përmendim shkurtimisht:

[26] https://www.parlament.al/LibrariaAkteve/LibrariaAkteDetails/7673

[27] https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2020/08/Internet-Governance-1-1.pdf

Neni 2 i ***Traktatit për Bashkimin Evropian***. BE-ja bazohet në vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Kjo përfshin respektimin e lirisë së medias dhe pluralizmit dhe të drejtën e lirisë së shprehjes, dhe kërkon përpjekje të vazhdueshme për të mbrojtur media të lira, pluraliste dhe të pavarura, të cilat janë një komponent kyç i demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Neni 11 i ***Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian***. E drejta për lirinë e shprehjes, e sanksionuar nga i njëjti nen, përfshin lirinë e mendimit dhe për të marrë e për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje nga autoriteti publik dhe pavarësisht nga kufijtë, liria dhe pluralizmi i medias do të respektohet.

Në ***Planin e Veprimit për Demokracinë Evropiane***[28], Komisioni Evropian paraqiti një udhërrëfyes ambicioz për të fuqizuar qytetarët dhe për të ndërtuar demokraci më elastike në të gjithë BE-në, duke theksuar rolin e rëndësishëm që luajnë mediat e pavarura dhe pluraliste duke u mundësuar qytetarëve që të marrin vendime të informuara, si dhe rolin që kanë në luftën kundër dezinformimit. Për këtë qëllim, Plani parashikon një seri rezultatesh konkrete që synojnë të mbështesin dhe ruajnë lirinë e medias dhe pluralizmin, për të luftuar paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike.

Rekomandimin e Komisionit Evropian "Për garantimin e mbrojtjes, sigurisë dhe fuqizimit të gazetarëve si dhe profesionistëve të tjerë të medias në Bashkimin Evropian[29]". Rekomandimi është pjesë e punës së Komisionit për të mbështetur lirinë dhe pluralizmin e medias në BE. Ai synon të sigurojë kushte më të sigurta pune për të gjithë profesionistët e medias, pa frikë dhe frikësim, qoftë *online* apo *offline*. Ai përcakton veprime konkrete që shtetet anëtare duhet të ndërmarrin, me një vëmendje të veçantë për gazetaret femra. Shtetet anëtare duhet të hetojnë dhe ndjekin penalisht të gjitha aktet kriminale të kryera kundër gazetarëve, qofshin *online* ose *offline*, në mënyrë të paanshme, të pavarur, efektive, transparente dhe në kohë, duke shfrytëzuar plotësisht atë legjislacion ekzistues kombëtar dhe evropian, për të siguruar që të drejtat themelore të mbrohen dhe drejtësia të jetë e shpejtë dhe të parandalojnë shfaqjen e një "kulture të pandëshkueshmërisë" në lidhje me sulmet ndaj gazetarëve. Shtetet anëtare duhet të njohin rolin e gazetarëve gjatë tubimeve publike, protestave dhe demonstratave në ofrimin e informacionit për ngjarje të tilla për publikun dhe duhet të sigurojnë që gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias të jenë në gjendje të veprojnë në mënyrë të sigurt dhe pa kufizime gjatë ngjarjeve të tilla. Shtetet anëtare duhet të ofrojnë trajnime të rregullta për agjencitë e zbatimit të ligjit, për të përmirësuar kapacitetin e tyre për të garantuar sigurinë publike duke mbrojtur në të njëjtën kohë gazetarët dhe jo duke i penguar ata nga aftësia për të raportuar".

Këshilli i Bashkimit Evropian [30] ka miratuar gjithashtu konkluzione të rëndësishme në lidhje me mbrojtjen e gazetarisë. Për shembull, në vitin 2018, Këshilli miratoi Konkluzionet për

[28] Planin e Veprimit për Demokracinë Evropiane, 3.12.2020, https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0790&from=EN

[29] Rekomandimi i Komisionit Evropian "Për garantimin e mbrojtjes, sigurisë dhe fuqizimit të gazetarëve si dhe profesionistëve të tjerë të medias në Bashkimin Evropian", 16.9.2021, https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/recommendation-protection-safety-and-empowerment-journalists

[30] Konkluzionet për forcimin e përmbajtjes evropiane në ekonominë digjitale, 2018, Këshilli i Bashkimit Evropian https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52018XG1219(01)&from=EN#ntr1-C_2018457EN.01000201-E0001

forcimin e përmbajtjes evropiane në ekonominë digjitale, e cila nënvizonte se "*kushtet e sigurta të punës për gazetarët janë thelbësorë në ndryshimin e peisazhit mediatik për të garantuar profesionalizëm dhe gazetari të pavarur*".

- ***Parlamenti Evropian*** ka mbështetur në mënyrë aktive, rritjen e veprimit të BE-së për mbrojtjen e gazetarëve. Në raportin e tij të datës 25 nëntor 2020[31], Parlamenti u shpreh, me shqetësim të thellë për gjendjen e lirisë së medias në BE, në kontekstin e rasteve të abuzimit dhe sulmeve që ende kryhen kundër gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias. Ndërsa në Rezolutën e datës 29 prill 2021[32], Parlamenti theksoi se mbrojtja e gazetarëve investigativë dhe sinjalizuesve[33] është një interes jetik i shoqërisë. Ai gjithashtu theksoi, në Rezolutën e tij të 24 qershorit 2021[34], shqetësimet e tij lidhur me kërcënimet fizike, psikologjike dhe ekonomike të kryera ndaj gazetarëve dhe punonjës të tjerë të medias në BE. Që nga shkurti i vitit 2018, një grup deputetësh evropian[35] i bënë thirrje Komisionit të BE-së që të promovojë një direktivë të BE-së kundër padive strategjike dhe kundër pjesëmarrjes publike[36], e cila do t'u japë gazetarëve investigativë dhe grupeve të medias, fuqinë për të kërkuar që të rrëzojnë me shpejtësi "paditë shqetësuese" dhe do të krijojë një fond për financimin dhe mbështetjen e grupeve mediatike që i rezistojnë padive të tilla. Sa më sipër, Komisioni Evropian inicioi propozimin e një direktive mbi "Veprimin e BE-së kundër proceseve gjyqësore abuzive (SLAPP) që targetojnë, gazetarët dhe mbrojtësit e të drejtave"[37]. Ky projekt-akt ka qenë në proces konsultimi në periudhën 4 tetor 2021 -10 janar 2022 dhe gjatë vitit 2022 pritet propozimi i një akti të tillë nga KE. Legjislacioni Amerikan dhe Kanadez e kanë shumë të zhvilluar legjislacionin kundër padive të tilla. Legjislacioni dhe praktika gjyqësore janë veçanërisht të zhvilluara në SHBA, ku SLAPP-të njihen si shkelje e të drejtave të qytetarëve sipas Amendamentit të Parë, të Kushtetutës Amerikane, përkatësisht, liria e fjalës dhe e drejta për të bërë peticion kundër qeverisë për korrigjimin e ankesave. Rreth 30 nga 50 shtete të SHBA, kanë legjislacion specifik kundër këtyre padive. Kanada/ Neni 51 i Kodit të Procedurës Civil të Kebekut parashikon se: Gjykatat munden, në çdo kohë, me kërkesë dhe madje me iniciativën e tyre, të deklarojnë se një kërkesë gjyqësore ose një pretendim është abuziv. Pavarësisht nga qëllimi, shpërdorimi i procedurës mund të konsistojë në një kërkesë gjyqësore ose kur deklarata është qartësisht e pabazuar dhe

---

31 Raport mbi forcimin e lirisë së medias: mbrojtja e gazetarëve në Evropë, gjuha e urrejtjes, dezinformimi dhe roli i platformave, 3.11.2020, Parlamenti Evropian https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/A-9-2020-0205_EN.pdf

32 Rezoluta e Parlamentit Evropian e 29 prillit 2021 mbi vrasjen e Daphne Caruana Galizia dhe sundimin e ligjit në Maltë, 29 April 2021, https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2021-0148_EN.html

33 Duhet theksuar se Direktiva (BE) 2019/1937 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 23 tetor 2019 për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjit të Unionit u miratua më 23 tetor 2019 dhe ka hyrë në fuqi më 16 dhjetor 2019. Shtetet Anëtare kishin afat deri më 17 dhjetor 2021 për ta transpozuar atë në ligjet e tyre kombëtare. Direktiva ofron standarde të përbashkëta të mbrojtjes në të gjithë BE-në për sinjalizuesit që ngrenë shkelje të ligjit të BE-së me punëdhënësin e tyre.

34 Rezoluta e Parlamentit Evropian e 24 qershorit 2021 mbi Raportin e Komisionit për Sundimin e Ligjit 2020, https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2021-0313_EN.html

35 https://www.ecpmf.eu/slapp-the-background-of-strategic-laësuits-against-public-participation/

36 Strategic Lawsuits Against Public Participation-SLAPP

37 https://ec.europa.eu/info/laë/better-regulation/have-your-say/initiatives/13192-EU-action-against-abusive-litigation-SLAPP-targeting-journalists-and-rights-defenders/public-consultation_en

joserioze ose ka si synim për ta vonuar ose kryhet për të shqetësuar palën e paditur. Mund të konsistojë gjithashtu në një përdorim të procedurës që është e tepruar ose e paarsyeshme ose që shkakton paragjykim ndaj një personi tjetër, ose përpjekje për të mposhtur qëllimet e drejtësisë, veçanërisht nëse ajo vepron për të kufizuar lirinë e shprehjes së një personi tjetër në një debat publik.[38]

Vendimet e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE)[39] përcaktojnë standarde sa i përket garantimit të lirisë së medias dhe gazetarëve. Ndër më të fundit të gjykuar, i cili ka lidhje me lirinë e medias, përmendim rastin e një gazetari (Mr.A), i cili publikoi dy artikuj në faqen e internetit të Daily Mail (të parin në 8 qershor 2011 dhe të dytin në 12 qershor 2012) duke raportuar thashethemet për ofertat e blerjes për aksionet e kompanive Hermès (nga LVMH) dhe Maurel & Prom. Çmimet e treguara në atë artikull ishin dukshëm më të larta se çmimet e atyre aksioneve në Euronext. Ai publikim çoi në një rritje të konsiderueshme të çmimit të këtyre aksioneve. Pak para publikimit të këtyre artikujve, nga disa qytetarë britanikë u bënë blerje të aksioneve në fjalë, të cilët më pas i shitën ato aksione sapo ishin publikuar këto artikuj. Autoriteti i Tregjeve Financiare në Francë, në 24 tetor 2018 vendosi një gjobë prej 40.000 € për gazetarin sepse ai i kishte treguar qytetarëve britanikë për botimin e ardhshëm të artikujve të tij dhe kështu i kishte zbuluar atyre "informacione të brendshme". Ky vendim u ankimua në gjykatë. Gjykata e Apelit në Paris i bëri një kërkesë GJDBE, për një vendim paraprak në lidhje me interpretimin e dispozitave të ligjit të BE-së për "marrëdhëniet e brendshme". Së pari, pyetën nëse informacioni në lidhje me "publikimin e ardhshëm të një artikulli në shtyp që raporton një thashethem në treg mund të konsiderohet si "informacion i brendshëm", zbulimi i të cilave është i ndaluar". Së dyti, ajo pyet GJDBE në qoftë se ka përjashtime nga ai ndalim, në kontekstin e veçantë të veprimtarisë së gazetarisë. Kështu sipas Vendimit të GJDBE (Dhomës së Madhe) të datës 15 mars 2022 në çështjen nr. C-302/20[40] është vendosur se: "*zbulimi nga një gazetar, "i informacionit të brendshëm" në lidhje me publikimin e ardhshëm të një artikulli që raporton thashetheme në lidhje me kompanitë e listuara në bursë është i ligjshëm kur është i nevojshëm për qëllimin e kryerjes së një veprimtarie gazetarie dhe respekton parimin e proporcionalitetit*".

III.2.2 Standardet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB)

Referuar standardeve të përcaktuara nga OKB, vlen të përmendim shkurtimisht një numër të madh Rezolutash të veçanta që kanë për qëllim të rrisin nivelin e mbrojtjes së gazetarëve në vendet anëtare[41]. Rreth 12 rezoluta deri më sot i referohen vetëm sigurisë së gazetarëve, por gjithashtu edhe për të dënuar gjendjen aktuale të pandëshkueshmërisë për veprimet e dhunës ndaj gazetarëve dhe të cilat kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit të tyre.

---

38 Studimi i Parlamentit Evropian mbi përdorimin e Padive SLAPP për të heshtur gazetarët, dhe OSHC-ët https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2021/694782/IPOL_STU(2021)694782_EN.pdf

39 GJDBE interpreton legjislacionin e BE-së për t'u siguruar që ai zbatohet në të njëjtën mënyrë në të gjitha vendet e BE-së dhe zgjidh mosmarrëveshjet ligjore ndërmjet qeverive kombëtare dhe institucioneve të BE-së;

40 Vendim i GJDBE (Dhoma e Madhe), 15 mars 2022, nr. C-302/20, https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=255862&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=67926

41 https://www.ohchr.org/EN/Issues/SafetyOfJournalists/Pages/resolutions.aspx

- ***Rezoluta mbi sigurinë e gazetarëve nr. 21/12 (viti 2012)***[42], miratuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut, në të cilën citohet se "Këshilli shpreh shqetësimin e tij që sulmet ndaj gazetarëve shpeshherë kalojnë pa u ndëshkuar askush dhe ai u bën thirrje shteteve që të sigurojnë përgjegjësi duke kryer hetime të paanshme, të shpejta dhe efektive për ato akte që bien në kompetencat e tyre, për të vendosur personat përgjegjës për sulmet para drejtësisë, si dhe t'u sigurojë viktimave akses në mjetet juridike përkatëse".
- ***Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nr. 68/163 (viti 2013)***, mbi sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e pandëshkueshmërisë [43], në të cilën citohet se "Asambleja e Përgjithshme u bën thirrje shteteve anëtare të bëjnë çmos për të parandaluar dhunën ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias, të sigurojnë përgjegjësi duke kryer hetime të paanshme, të shpejta dhe efektive për të gjitha pretendimet e dhunës ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias nën juridiksionin e tyre dhe të sjellin para drejtësisë autorët e krimeve të tilla. Asambleja u bën thirrje shteteve të promovojnë një mjedis të sigurt për gazetarët për të kryer punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje të panevojshme, duke përfshirë zbatimin e: (a) masave ligjore; (b) ndërgjegjësimit në sistemin gjyqësor dhe midis zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe personelit ushtarak, si dhe midis gazetarëve dhe shoqërisë civile, për të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe detyrimet ligjore humanitare lidhur me sigurinë e gazetarëve; (c) monitorimit dhe raportimit për sulmet ndaj gazetarëve; (d) dënimit publik të sulmeve ndaj gazetarëve; etj.
- ***Rezoluta e Këshillit për të Drejtat e Njeriut, për sigurinë e gazetarëve nr. 27/5 (viti 2014),*** në të cilën citohet se "Këshilli u bën thirrje shteteve të zhvillojnë dhe zbatojnë strategji për të luftuar mosndëshkimin për sulme dhe dhunë ndaj gazetarëve, duke përfshirë këtu edhe atë përmes përdorimit, kur është e përshtatshme, të praktikave të mira, ndër të tjera: (a) krijimin e njësive të posaçme hetimore ose komisione të pavarura; (b) emërimin e prokurorëve të specializuar; (c) miratimin e protokolleve dhe metodave specifike të hetimit dhe ndjekjes penale; (d) trajnimin e prokurorëve dhe gjyqësorit për sigurinë e gazetarëve; (e) vendosjen e mekanizmave të mbledhjes së informatave, siç janë bazat e të dhënave, për të mundësuar mbledhjen e informacionit të verifikuar për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve; (f) vendosjen e një mekanizmi për paralajmërim të hershëm dhe reagimin e shpejtë për t'u mundësuar gazetarëve, akses të menjëhershëm tek autoritetet dhe masat mbrojtëse.
- ***Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit nr. 69/185 (viti 2014)***[44], në të cilën citohet se "Asambleja e Përgjithshme dënon të gjitha sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias, siç janë tortura, vrasje pa gjyq, zhdukje me forcë, arrestime arbitrare dhe paraburgime arbitrare, si dhe kërcënime dhe ngacmime si në situata

---

[42] Rezoluta mbi sigurinë e gazetarëve nr. 21/12, 2012, https://undocs.org/A/HRC/RES/21/12

[43] Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nr. 68/163, 2013, https://undocs.org/en/A/RES/68/163

[44] Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit nr. 69/185, 2014, https://undocs.org/en/A/RES/69/185

konflikti dhe jo konflikti. Asambleja dënon ashpër pandëshkueshmërinë që mbizotëron për sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve dhe shpreh shqetësimin e saj të thellë që shumica e këtyre krimeve ngelin të pandëshkuar, gjë që nga ana tjetër kontribuon në përsëritjen e këtyre krimeve. Ajo u bën thirrje shteteve anëtare që të bëjnë çmos për të parandaluar dhunën, kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias, të sigurojnë përgjegjshmëri duke kryer hetime të paanshme, të shpejta, të plota, të pavarura dhe efektive për të gjitha pretendimet e dhunës, kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias që janë nën juridiksionin e tyre për të vendosur para drejtësisë dhunuesit, duke përfshirë këtu edhe ata që kanë urdhëruar sulmet, kanë ndihmuar për të kryer ose për të fshehur ndonjë vepër penale dhe për t'u siguruar viktimave dhe familjeve të tyre akses tek mjetet juridike përkatëse".

- Në po të njëjtën linjë është dhe ***Rezoluta e miratuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut, e datës 27 shtator 2018***[45], me anë të së cilës "inkurajohen shtetet të sigurojnë përgjegjësi duke kryer hetime të paanshme, në kohë, të plotë, të pavarur dhe efektive për të gjitha akuzat për dhunë, kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias, për të sjellë autorët para sistemit së drejtësisë, duke përfshirë këtu edhe ata që kanë dhënë urdhër, kanë komplotuar për të kryer, ndihmuar ose për të mbuluar krime të tilla, si dhe të sigurojnë që viktimat dhe familjet e tyre të kenë akses në mjetet juridike përkatëse".

III.2.3 Standardet e Këshillit të Evropës

Referuar standardeve të përcaktuara nga Këshilli i Evropës, më sipër është përmendur Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore (në vijim Konventa), por duhet të theksojmë se përgjatë shumë viteve, neni 10 i saj është interpretuar, nëpërmjet vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe nga organet e kësaj organizate të cilat kanë nxjerrë një sërë rezolutash, rekomandime e deklarata, që mbulojnë çështje të tilla si aksesi në informacion, çrrënjosja e mosndëshkimit për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, pluralizmi mediatik dhe transparenca e pronësisë, barazia gjinore dhe media, mbrojtja dhe promovimi i gazetarisë hulumtuese, mbrojtja e burimeve dhe sinjalizuesve, mbrojtja e gazetarëve në situata konflikti dhe tensioni, liria e shprehjes dhe informimit në media në luftën kundër terrorizmit, pavarësia e shërbimit publik të transmetimit, mbulimi mediatik i fushatave zgjedhore, etj. Më poshtë përmendim në mënyrë të përmbledhur:

- ***Rekomandimin e Komitetit të Ministrave mbi të drejtën e gazetarëve për të mbrojtur burimet e informacionit (2000)***[46]**,** i cili përcakton sugjerime të detajuara rreth detyrimeve të autoriteteve dhe të drejtës së gazetarit për të heshtur me qëllim që të mbrojë burimet e informacionit.

---

[45] Rezoluta e miratuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut, 27 shtator 2018, https://undocs.org/en/A/HRC/RES/45/18

[46] Rekomandimin e Komitetit të Ministrave mbi të drejtën e gazetarëve për të mbrojtur burimet e informacionit, 2000,https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-no-r-2000-7-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-the-right-of-journalists-not-to-disclose-their-sources-of-information?inheritRedirect=false

- ***Rekomandimi për barazinë gjinore dhe median (2013)***[47], i cili bën thirrje për të luftuar stereotipet seksiste dhe dhunën me bazë gjinore në media.
- Udhëzime veçanërisht të detajuara për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias gjenden në ***Rekomandimin e Komitetit të Ministrave (2016)***[48]. Ky akt mbron çdo person ose ent që kontribuon në debat publik, duke përfshirë gazetarët, sinjalizuesit, akademikët OSHC-të etj, i cili kërkon që shtetet të krijojnë një *mjedis të favorshëm* për ushtrimin e së drejtës për lirinë e shprehjes dhe të ofrojnë kushte në të cilat mund të lulëzojë debati i fuqishëm publik. Për zbatimin e plotë të Rekomandimit në pjesën e mbrojtjes së gazetarëve dhe ndjekjes penale të autorëve të veprave penale kundër gazetarëve, Këshilli i Evropës ka miratuar edhe një Udhëzues për zbatimin e temave të zgjedhura për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave.
- ***Rekomandimi për pluralizmin mediatik dhe transparencën e pronësisë së medias (2018)***[49], i cili trajton çështjet e pluralizmit dhe diversitetit mediatik në mjedisin e ri të multimedias.
- ***Rezoluta nr. 2317 (2020) miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës***, e cila u bën thirrje shteteve anëtare që të mbrojnë në mënyrë më efektive sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e mediave.
- ***Rekomandimi nr. 4 (2022) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi promovimin e një mjedisi të favorshëm për gazetari cilësore në epokën digjitale***[50]. Rekomandimi përmban një sërë udhëzimesh ligjore, administrative dhe praktike që synojnë sigurimin e financimit të qëndrueshëm për media cilësore, ndërtimin e besimit në gazetari dhe promovimin e shkrim-leximit mediatik. Rekomandimi inkurajon shtetet që të miratojnë masa të favorshme rregullatore dhe fiskale për median, duke përfshirë mbështetjen e drejtpërdrejtë aty ku është e përshtatshme, duke vendosur masa të forta mbrojtëse për të mbrojtur pavarësinë e medias. Ky akt ndër të tjera rekomandon se shtetet duhet të marrin në konsideratë, në bashkëpunim të ngushtë me shoqatat kombëtare të gazetarëve, sindikatat dhe organizatat përkatëse të shoqërisë civile, krijimin e fondeve kombëtare, granteve dhe/ose asistencës tjetër të synuar për gazetarinë investigative, ose mbështetjen për fondet ose projektet ekzistuese që synojnë financimin e hetimeve për çështje të interesit publik, ofrimin e trajnimeve për gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias të përfshirë në praktikën e gazetarisë investigative, mbështetjen e nismave bashkëpunuese dhe e rrjeteve të organizatave të gazetarisë investigative, duke përfshirë edhe karakterin ndërkombëtar dhe zhvillimin e mjeteve digjitale të afta për

---

[47] Rekomandimi për barazinë gjinore dhe median, 2013, https://www.coe.int/en/ëeb/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-cm-rec-2013-1-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-gender-equality-and-media-adopted-by-the-committee-of-ministers-on-10-j?_101_INSTANCE_aDXmrol0vvsU_viewMode=view/

[48] Rekomandimin e Komitetit të Ministrave për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias, 2016, https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016806415d9#_ftn1

[49] Rekomandimi për pluralizmin mediatik dhe transparencën e pronësisë së medias, 2018, https://rm.coe.int/leaflet-media-freedom-en/16808b53e4

[50] Rekomandimi nr. 4 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi promovimin e një mjedisi të favorshëm për gazetari cilësore në epokën dixhitale, 2022, https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectid=0900001680a5ddd0

të përmirësuar kërkimin dhe raportimin gazetaresk. Statutet e këtyre fondeve duhet të garantojnë se ato nuk janë për qëllime fitimi, të operuara nga një organ i pavarur dhe të udhëhequr nga parimet e transparencës dhe llogaridhënies. Fonde të tilla mund të marrin grante dhe subvencione publike dhe donacione private, transparenca e të cilave duhet të garantohet.

Gjithashtu, ***Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj)*** e ka konsideruar Konventën "një instrument të gjallë" duke prezantuar dhe konceptin e "konsensusit evropian"[51] për t'iu referuar nivelit të uniformitetit të zbatimit në kuadrin ligjor të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për një temë të caktuar. Teksti i Konventës[52] nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet jashtë jurisprudencës të saj. Vendimet e GjEDNj shpjegojnë dhe interpretojnë tekstet dhe ato <u>përbëjnë precedentë të detyrueshëm</u>. Kështu, me ratifikimin e Konventës, autoritetet kombëtare të të gjitha shteteve nënshkruese, duke përfshirë ato që praktikojnë një sistem ligjor civil (kontinental), duhet të konsiderojnë vendimet e Gjykatës si akte të detyrueshme. Gjykata ka sqaruar se "*Neni 10 i Konventës jo vetëm që kërkon që shtetet të përmbahen nga ndërhyrjet e panevojshme në lirinë e shprehjes, por se shtetet janë gjithashtu të detyruara të krijojnë një mjedis për pjesëmarrjen e plotë në debatin publik nga të gjithë, pa frikë. Për më tepër, për të mbrojtur të drejtën për jetë, shtetet duhet të kenë dispozita efektive të ligjit penal për të penguar kryerjen e veprave, të mbështetura nga struktura efektive të zbatimit të ligjit dhe të marrin masa parandaluese operacionale për të mbrojtur individët, jetët e të cilëve janë në rrezik*". Gjykata ka theksuar gjithashtu se "*Shtetet duhet të mbrojnë gazetarët dhe të krijojnë një mjedis të favorshëm për debat publik edhe kur mendimet që gazetarët shprehin, janë në kundërshtim me ato të autoriteteve ose të një pjese të konsiderueshme të opinionit publik, madje edhe nëse ato janë të bezdisshme ose tronditëse".*

Neni 10 i Konventës nuk përmend në mënyrë të hapur lirinë e shtypit, por GjEDNj ka zhvilluar jurisprudencë të gjerë duke formuar një grup parimesh dhe rregullash që i japin "*shtypit*" një status të veçantë në gëzimin e lirive që përbëjnë nenin 10. Jurisprudenca e GjEDNj ka vendosur një mbrojtje të fortë ndaj lirisë së shprehjes, dhe në veçanti shtypit në misionin e tij informativ dhe investigues, ndaj politikanëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur.

Në Vendimin e datës 17.12.1976, ***në çështjen Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar***[53], GjEDNj shprehet se "*Liria e shprehjes është një nga shtyllat e shoqërisë demokratike, bazë për zhvillimin e saj dhe kusht për vetë realizimin e individit… Ajo nuk mund të përfshijë vetëm informacionet dhe opinionet e perceptuara pozitivisht, ose të konsideruara si të padëmshme, apo indiferente, por edhe të tilla që fyejnë, turbullojnë, apo që janë shqetësim për shtetin ose për një grup të caktuar të shoqërisë. Të tilla janë kriteret e pluralizmit, të tolerancës dhe të hapjes, pa të cilat një shoqëri demokratike nuk mund të ekzistojë...".*

"Roli i shtypit si një mbikëqyrës ndaj politikës" u vu në dukje për herë të parë nga Gjykata ***në çështjen Lingens (1986) kundër Kancelarit të Austrisë***[54]. Në disa artikuj gazetari kishte

---

51 https://www.coe.int/en/web/help/article-echr-case-law

52 https://rm.coe.int/handbook-2/16806fc139

53 GjEDNj, Vendim i datës 17.12.1976, Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22fulltext%22:[%22Handyside%20v%20United%20Kingdom%22],%22documentcollectionid2%22:[%22JUDGMENTS%22],%22itemid%22:[%22001-57499%22]}

54 GjEDNj, 1986, Lingens kundër Kancelarit të Austrisë, http://jus.igjk.rks-gov.net/770/1/Book_ECHR_ALB.pdf

kritikuar z. Kreisky, Kancelarin e atëhershëm të Republikës Federale të Austrisë për një lëvizje të veçantë politike që kishte bërë, që bënte palë për shpalljen e një koalicioni me një parti që drejtohej nga një person që kishte prejardhje Naziste. Gazetari (M.Lingens) e quajti sjelljen e Kancelarit si "*imorale*", "*të padenjë*" dhe provë e "*oportunizmit më të ulët*". Pas një procedimi ligjor privat që u bë nga Kancelari, gjykatat Austriake i quajtën këto deklarata si shpifëse dhe e dënuan gazetarin me një gjobë. Ndërsa argumentohej faji i tij, gjykatat shpallën gjithashtu se gazetari nuk mund të provonte vërtetësinë e pretendimeve të tij. GjEDNj shpalli se qëndrimet e gjykatave kombëtare ishin të gabuara duke qenë *se mendimet (qëllimi i mirë) nuk duhet të demonstrohen dhe nuk janë të predispozueshme për t'u provuar.* Në të njëjtin gjykim, Gjykata argumentoi që liria e shtypit, i jep publikut një nga mjetet më të mira për të zbuluar dhe për të formuar një mendim mbi idetë dhe qëndrimet e drejtuesve politikanë dhe si rrjedhim, liria e debatit politik është pikërisht në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike. Për këtë arsye, Gjykata i jep debatit politik nga shtypi një mbrojtje të fortë sipas Nenit 10. Duke arritur njëzëri në mbajtjen e një qëndrimi, që është guida themelore për gazetarët në përplasjet e tyre me politikanët, Gjykata në këtë vendim mbajti qëndrimin se *dënimi penal i një gazetari, z. Lingens, për kritika ndaj kancelarit federal në rastin në fjalë përbën shkelje të lirisë së tij të shprehjes siç mbrohet nga neni 10 i Konventës. Thelbi i këtij qëndrimi konsiston në momentin se masa e marrë ishte joproporcionale dhe si e tillë e panevojshme në një shoqëri demokratike. Pranohet se ky vendim përbën guidën themelore për interpretimin e nenit 10 në përplasjet gazetar – politikan, për faktin se bën një pohim tepër të rëndësishëm*: "*autoritetet shtetërore nuk mund t'u kërkojnë gazetarëve që të provojnë vërtetësinë e deklaratave të tyre ndaj figurave politike, të cilat janë gjykime vlerësuese dhe janë bërë në mirëbesim".*

Një tjetër aspekt në kontekstin e lirisë së shtypit është botimi i thashethemeve dhe pretendimeve të cilat gazetarët nuk kanë mundësi t'i provojnë. Gjykata është shprehur se qëllimi i mirë nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë kërkese për prove. Duke qenë se liria që po diskutojmë i referohet dhënies së informacionit dhe të ideve, bëhet i rëndësishëm dallimi që ka përcaktuar Gjykata në këtë fazë të hershme. Duke bërë një dallim të qartë midis informacionit (fakteve) dhe mendimeve (gjykimet mbi vlerat), Gjykata është shprehur se "*ekzistenca e fakteve mund të demonstrohet, kurse e vërteta e vlerave nuk është e prekshme si provë*". Në lidhje me gjykimet mbi vlerat kjo kërkesë është e pamundur të përmbushet dhe dhunon vetë lirinë e mendimit, e cila është një pjesë themelore e të drejtës së siguruar nga Neni 10 i Konventës[55]. Vendimi i GjEDNj për çështjen Lingens kundër Kancelarit të Austrisë përbën në fakt mbrojtjen më të madhe që mund t'i ofrojë Konventa personave që përfitojnë nga liria e shprehjes së tyre. Ky parim është zbatuar nga GjEDNj në një sërë vendimesh vijuese.[56]

Në 2008, GjEDNj konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 10 në ***çështjen "Lopes Gomes da Silva kundër Portugalisë"***. Vicente Jorge Lopes Gomes da Silva, i cili në kohën në fjalë

[55] Po aty, http://jus.igjk.rks-gov.net/770/1/Book_ECHR_ALB.pdf

[56] GjEDNj, Oberschlick kundër Austrisë, 1991- Gjykata vlerësoi shkelje vetëm sepse gjykatat austriake i kishin kërkuar Z. Oberschlick të provonte vërtetësinë e thënieve të tij që në fakt ishin gjykime vlerësuese. https://hudoc.echr.coe.int/tur#{%22itemid%22:[%22001-57716%22]} http://jus.igjk.rks-gov.net/770/1/Book_ECHR_ALB.pdf

ishte menaxher i një gazete të përditshme Público, u dënua për shpifje. Gjykata deklaroi në veçanti se "*liria e shprehjes ishte e një rëndësie të veçantë për sa i përket shtypit e limitet e kriticizmit të pranueshëm janë më të gjera në lidhje me një politikan që vepron në funksionin e tij publik*".

Në çështjen "Dalban kundër Rumanisë" (1999), një gazetar akuzoi një politikan për korrupsion dhe keq menaxhim të pasurive shtetërore, GjEDNj u shpreh se "*liria e medias mbulon gjithashtu rekurse të mundshme deri në shkallën e ekzagjerimit, ose edhe në provokim*". Dallimi midis "fakteve" dhe "mendimeve" dhe "ndalimi i kërkesës për prova" në lidhje me këtë të fundit bëhet mjaft i rëndësishëm në sisteme ligjore vendase që akoma e parashtrojnë këtë kërkesë si krim për "fyerje". Për më tepër, edhe në lidhje me faktet, Gjykata e ka njohur mbrojtjen në bazë të qëllimit të mirë duke i lënë medias "një hapësirë ku mund të pranohen gabimet". Për shembull, në Dalban, Gjykata vëzhgoi që "nuk ka prova që përshkrimi i ngjarjeve i dhënë në artikuj ishte tërësisht i pavërtetë dhe se ishte hartuar për të nxitur një fushatë përgojimi kundër G.S.". Kryesisht, mbrojtja në bazë të qëllimit të mirë ka edhe nevojën për të provuar të vërtetën (mbrojtja e "barrës së provës"). *Nëse një gazetar ose një botim ka qëllime legjitime, çështja është e interesit publik, dhe nëse janë bërë përpjekje të arsyeshme për të vërtetuar faktet, shtypi nuk do të jetë përgjegjës nëse faktet vërtetohen se janë të pavërteta.*

Artikujt e gazetave të cilat përmbajnë citime apo pjesë nga gazeta të tjera, kanë dhënë shpesh shkak për procese për shpifje, të cilat janë marrë për shqyrtim në vijim nga ana e Gjykatës së Strasburgut. Në ***çështjen "Bladet Tromso kundër Norvegjisë"***[57], GjEDNj vendosi se "*shtypi duhet të ketë të drejtë të mbështetet në përmbajtjen e raporteve zyrtare, pa qenë nevoja të ndërmarrë kërkime të pavarura për të verifikuar vërtetësinë e informacionit që ato përmbajnë*".

Në ***çështjen "Bergens Tidende kundër Norvegjisë"***[58], GjEDNj konstaton se "*kur një gazetë përmban artikuj që citojnë apo përmbajnë pjesë që janë të besueshme dhe të kujdesshme, procedimet për shpifje mund të përbëjnë një ndërhyrje jo të justifikueshme ndaj të drejtave të parashikuara në nenin 10 të Konventës*". Një shqyrtim më i kujdesshëm kërkohet në rastet kur e drejta e brendshme nuk e lejon mbrojtjen që të pretendojë se deklaratat objekt i mosmarrëveshjes janë të vërteta.

Në çështjen "Castells kundër Spanjës"[59], GjEDNj kishte vendosur ndërkaq që e drejta spanjolle që penalizonte sharjen e qeverisë, shkelte nenin 10 të Konventës. Sipas Gjykatës, *mbrojtja që ofron ky nen ndaj shprehjes që kritikon strukturat e një qeverie, është më e gjerë sesa kur shprehja kritikon politikanë konkretë*. Kriteri i vendosur nga Gjykata në këtë çështje është zbatuar prej saj edhe në çështje vijuese me rrethana të ngjashme, fakt që tregon se është bërë tashmë një bazë solide e jurisprudencës në interpretimin e nenit 10.

---

[57] GjEDNj, Bladet Tromso kundër Norvegjisë, 20 maj 1999, http://jus.igjk.rks-gov.net/770/1/Book_ECHR_ALB.pdf

[58] GjEDNj, Bergens Tidende kundër Norvegjisë, 2 maj 2000, http://jus.igjk.rks-gov.net/770/1/Book_ECHR_ALB.pdf

[59] GjEDNj, Castells kundër Spanjës, 2 prill 1992, http://jus.igjk.rks-gov.net/770/1/Book_ECHR_ALB.pdf

E drejta e lirisë së shprehjes zbatohet dhe për format e reja të komunikimit masiv duke përfshirë këtu dhe internetin. Këshilli i Evropës është vazhdimisht aktiv për mbrojtjen e kësaj të drejte. Praktika gjyqësore e GjEDNj -së për lirinë e shprehjes garanton gjithashtu dhe "*aksesin në internet*"[60]. Një nga rastet më relevante me interes të veçantë për qeverisjen e internetit është ***çështja e Ahmedit Yildirim kundër Turqisë (18 dhjetor 2012)***[61]. Gjykata përcaktoi se "*neni 10 garantonte lirinë e shprehjes për "të gjithë" dhe zbatohej jo vetëm për përmbajtjen e informacionit por edhe mjeteve të shpërndarjes së tij*". Në këtë vendim citohet se "*interneti tashmë është bërë një nga mjetet kryesore me të cilat individët ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes dhe informacionit, duke ofruar ashtu siç bën mjete thelbësore për pjesëmarrje në aktivitete dhe diskutimet lidhur me çështjet politike dhe çështjet me interes të përgjithshëm*". GjEDNj është shprehur se "*dhuna e kryer ndaj gazetarëve, veçanërisht nga agjentë të shtetit, mund të përbëjë shkelje jo vetëm të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili ndalon torturën dhe trajtimin ose dënimin çnjerëzor ose poshtërues, por gjithashtu të së drejtës për lirinë e shprehjes, e garantuar nga neni 10, që përfshin të drejtën për të marrë dhe për të dhënë informacion*".

Për shembull, në ***çështjen Najafli kundër Azerbajxhanit***[62], Gjykata vendosi se "*çdo masë që pengon gazetarët të bëjnë punën e tyre, mund të ngrejë çështje sipas nenit 10 dhe arriti në përfundimin se kishte pasur një shkelje për shkak të përdorimit të forcës së tepruar kundër kërkuesit*". Ky i fundit kishte mbajtur në gjoks distinktivin e gazetarit dhe u kishte thënë policëve se ishte gazetar. Pavarësisht nëse ka pasur apo jo ndonjë qëllim nga ana e policisë për të ndërhyrë në veprimtarinë gazetareske, ajo që ka rëndësi është se gazetari i është nënshtruar përdorimit të panevojshëm dhe të tepruar të forcës, pavarësisht se ka bërë përpjekje të qarta për të identifikuar veten si gazetar që thjesht po bënte punën e tij dhe po vëzhgonte ngjarjen. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se "*në kontekstin e demonstratave publike, prania e gazetarëve është një garanci që autoritetet të mbajnë përgjegjësi për sjelljen e tyre përballë demonstruesve dhe publikut në përgjithësi, duke përfshirë metodat e përdorura nga policia në tubime të mëdha, për të kontrolluar ose shpërndarë protestuesit, ose për të ruajtur rendin publik*".

Sipas standardeve ndërkombëtare të vendosura nga GjEDNj "*dëmshpërblimi për dëmtim të reputacionit duhet të jetë proporcional, sepse në të kundërt mund të ketë efekt frenimi te gazetarët dhe mund të çojë edhe te mbyllja e tërësishme e medias*". ***Çështja Independent Newspapers (Ireland) Limited kundër Irlandës***[63] ka të bëjë me gazetën irlandeze 'The Evening Herald', e cila kishte publikuar rreth 11 shkrime me të cilat, bazuar në thashetheme, sugjeronte se një konsulente kishte përfituar kontrata nga qeveria për shkak se ishte në lidhje intime me një ministër. Gazeta, ndonëse kishte pranuar se kishte shpifur dhe kishte botuar një kërkim faljeje, ishte dënuar me një milion euro dëmshpërblim. Gjykata vendosi

---

60 https://birn.eu.com/news-and-events/birn-albania-publishes-report-on-internet-governance/

61 GJEDNJ, Ahmedit Yildirim kundër Turqisë, 18 dhjetor 2012, https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:[%22001-115705%22]}

62 GJEDNJ, Najafli kundër Azerbajxhanit, 2 tetor 2012, https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-113299%22]} 2013

63 GJEDNJ, Independent Newspapers (Ireland) Limited kundër Irlandës, 15 qershor 2017, https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-174419%22]}

se "*dëmshpërblimi nuk ishte proporcional dhe kishte cenuar të drejtën e lirisë së shprehjes së gazetarit*".

III.2.4 Standardet e OSBE

OSBE-ja monitoron zhvillimet e medias, në shtetet e saj pjesëmarrëse, për shkelje të lirisë së shprehjes. Kjo përfshin monitorimin dhe kërkimin e përgjegjësisë për vrasjet, sulmet dhe ngacmimet e gazetarëve dhe ndjekjen penale të gazetarëve dhe anëtarëve të medias për aktivitetet e tyre profesionale, rishikimin e legjislacionit që mund të ndikojë në shprehjen e lirë dhe legjislacionit që rregullon median. OSBE gjithashtu angazhohet në zhvillimin e medias përmes trajnimit dhe mbështetjes për redaktorët dhe gazetarët. Disa dokumente të miratuara nga kjo organizatë në fushën e lirisë së shprehjes dhe medias janë:

- ***Dokumenti i Takimit të Moskës të Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të OSBE-së (1991),*** i cili citon se mediat e pavarura janë thelbësore për një shoqëri të lirë dhe të hapur dhe sistemet e përgjegjshme të qeverisjes janë të një rëndësie të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore.
- ***Vendimi për sigurinë e gazetarëve nga të 57 shtetet pjesëmarrëse në Këshillin Ministror të OSBE-së (2018)***[64] ku citohet se "Shtetet duhet të zbatojnë plotësisht zotimet e OSBE-së dhe obligimet e tyre ndërkombëtare lidhur me lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave, duke përfshirë përmes respektimit, promovimit dhe mbrojtjes së lirisë për të kërkuar, pranuar dhe shpërndarë informacione pavarësisht kufijve; miratojnë ligjet, politikat dhe praktikat e tyre që lidhen me lirinë e mediave në përputhshmëri të plotë me obligimet dhe zotimet e tyre ndërkombëtare dhe t'i rishikojnë, e sipas nevojës, shfuqizojnë apo ndryshojnë ato që të mos kufizojnë mundësitë e gazetarëve për të kryer punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje të panevojshme; *krijojnë ose forcojnë, kur është e mundur, mbledhjen, analizën dhe raportimin kombëtar të të dhënave për sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve*; sigurojnë që ligjet për shpifje nuk përmbajnë sanksione ose ndëshkime të tepruara që mund të dëmtojnë sigurinë e gazetarëve dhe/ose censurojnë në mënyrë efektive gazetarët dhe ndërhyjnë në misionin e tyre për të informuar publikun dhe, kur është e nevojshme, të rishikojnë dhe shfuqizojnë ligje të tilla, në përputhje me detyrimet e shteteve pjesëmarrëse sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
- ***Udhëzimet e Talinit për Pakicat Kombëtare dhe Mediat në Epokën Digjitale***, të cilat janë nxjerrë nga Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare në shkurt 2019, këshillojnë se si: i) të bëj funksionale të drejtën e lirisë së shprehjes në shoqëri të ndryshme dhe të mundësojë akses në një gamë të gjerë të mediave dhe teknologjive të informacionit pa diskriminim; ii) të krijojë dhe mbështesë një mjedis të favorshëm për debat pluralist në epokën digjitale në të cilën mund të marrin pjesë anëtarët e të gjitha grupeve të shoqërisë.

[64] Vendimi për sigurinë e gazetarëve nga të 57 shtetet pjesëmarrëse në Këshillin Ministror të OSBE-së, 2018, https://www.osce.org/files/mcdec0003%20safety%20of%20journalists%20en.pdf

III.3 SITUATA AKTUALE E LIRISË SË MEDIAS NË SHQIPËRI, RAPORTET NDËRKOMBËTARE DHE KOMBËTARE

Një sërë raportesh kombëtare dhe ndërkombëtare hedhin dritë mbi gjendjen e lirisë së shprehjes dhe medias në Shqipëri. Kështu, ndër më të rëndësishmet përmendim:

- ***Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë*** ku trajtohet dhe liria e medias;
- ***Raportet e Këshillit të Evropës*** për lirinë e shprehjes dhe deklaratat e Komisionerit për të drejtat e njeriut, si dhe;
- ***Raporte apo studime të organizatave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare***.

Sipas ***Raportit të Komisionit Evropian 2021***[65] për Shqipërinë citohet se: "... *Shqipëria ka një nivel të caktuar përgatitjeje/është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e lirisë së shprehjes. Nuk ka pasur progres gjatë periudhës raportuese. Nuk ka pasur përmirësim në atmosferën e sulmeve verbale, fushatat shpifëse dhe aktet kërcënuese ndaj gazetarëve. Sulmet e raportuara ndaj gazetarëve nuk kanë rezultuar me ndonjë dënim përfundimtar... Referuar kanosjes së gazetarëve vijon të ketë shqetësime serioze tek organizatat për lirinë e medias ndaj presionit politik, përdorimit të gjuhës kanosëse, kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve. Gjatë periudhës raportuese u vu re një numër i shtuar padish për shpifje ose padi strategjike ndaj përgatitjes publike ndaj grupeve mediatike ose gazetarëve individuale që vinin nga kompani dhe politikanë të fuqishëm me synimin për të censuruar dhe kanosur median kritike. Në vitin në vijim, Shqipëria duhet: Të garantojë një politikë me zero tolerancë ndaj kërcënimit dhe sulmeve ndaj gazetarëve, si edhe për kërcënimet ndaj medias, duke përfshirë ato në diskursin politik dhe në margjinat e demonstrimit ...*".

Sipas Indeksit Botëror të Lirisë së Shtypit 2022[66] Shqipëria renditet në vendin e *103-të nga 180* vende duke bërë që kjo renditje të jetë rënia më e madhe ndër vite për lirinë e medias (në vitin 2013, në vendin e 102-të ndërsa në vitet në vijim, pozita e Shqipërisë në këtë indeks pësoi rënie dhe ngritje, duke u renditur më mirë në vendin e 75 në vitin 2018, por duke rënë sërish në vendet 84 në vitin 2020 dhe 83 në vitin 2021).

Raporti nënvizoi se "*Ndërsa pavarësia editoriale kërcënohet nga rregullimi partizan i medias, integriteti fizik i gazetarëve cenohet nga krimi i organizuar, nga dështimi i shtetit për t'i mbrojtur ata dhe madje edhe nga dhuna policore. Gazetarët përballen me presione politike të cilat u përkeqësuan në vitin 2021 nga përpjekjet për të kontrolluar informacionin gjatë zgjedhjeve parlamentare dhe pandemisë Covid-19. Klasa politike kërcënon pavarësinë e redaksive nëpërmjet institucioneve shumë të politizuara të rregullimit të medias dhe menaxhimit të medias publike. Gazetarët kritikë ndaj qeverisë përballen me sulme të rregullta politike që synojnë t'i diskreditojnë ata dhe ata kanë vështirësi në aksesin e informacionit publik, gjë që rrezikon kufizime të mëtejshme nga një centralizim i kohëve të fundit referuar komunikimit të qeverisë. Rrjetet e organizuara kriminale nuk paraqesin rrezikun e vetëm për sigurinë fizike të gazetarëve. Mosndëshkimi i krimeve të kryera kundër gazetarëve, i*

[65] Raporti i Komisionit Evropian, 2021, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

[66] Reporters Without Borders, 2022, https://rsf.org/en/albania



Grafik nr.1: Renditja e Shqipërisë në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit ndër vite

kombinuar me përpjekjet politike për t'i diskredituar ata, krijon një klimë dhune që mund të nxisë sulme të reja kundër profesionistëve të medias. Në vitin 2021, reporterët që mbulonin protestat dhe operacionet e zbatimit të ligjit pësuan disa akte të dhunës policore".....".

Raporti Vjetor i vitit 2020 nga organizatat partnere në platformën e Këshillit të Evropës[67] për të promovuar mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve, vlerëson se "*në fund të dhjetorit 2019 kishte 11 alarme aktive në Shqipëri, me shtatë raste të reja të dorëzuara në Platformë në vitin 2019, krahasuar me një në vitin 2018. Kjo rritje e dukshme sinjalizon një përkeqësim të punës së gazetarëve dhe kushteve në vend*."

Raporti Freedom House 2021[68] e ka renditur Shqipërinë në vendin e *66 nga 100* sa i përket lirisë në Shqipëri (përfshirë dhe median) *duke u përkeqësuar me 1 pozicion*. Në këtë raport nënvizohet se "*në dhjetor 2019, parlamenti miratoi dy ligje që lejojnë agjencitë qeveritare të dëgjojnë ankesa nga individë që pretendojnë shpifje nga stacionet televizive dhe faqet e lajmeve. Sipas legjislacionit, këto agjenci do të kenë kompetencën të gjobisin gazetarët ose të kufizojnë aktivitetet e mediave që konstatohet se janë përfshirë në shpifje. Këshilli i Evropës kritikoi ligjin për parametrat e tij të paqartë dhe potencialin e tij për të penguar raportimin në internet*". Ndërsa po ky raport në vitin 2022[69] e ka renditur Shqipërinë në vendin e 67 nga 100 sa i përket lirisë në Shqipëri (përfshirë dhe median) duke u përkeqësuar me 1 pozicion.

Raporti mbi vlerësimin e politikës dhe ligjor mbi shtetin e së drejtës në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi nga Civil Rights Defenders[70] ***publikuar në muajin Mars 2021,*** nxori në pah se po ashtu, gazetarët janë paditur nga politikanë ose figura të tjera të rëndësishme. Raporti citon se "*gazetarët shqiptar shpesh u nënshtrohen proceseve*

[67] Raporti Vjetor i organizatave partnere në platformën e Këshillit të Evropës, mars 2020, https://rm.coe.int/annual-report-en-final-23-april-2020/16809e39dd

[68] https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2021

[69] https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2022

[70] https://crd.org/wp-content/uploads/2021/03/210210_PolicyPapers_Start_Summary_K4.pdf?fbclid=IwAR39trzkZpSJ1EdmeflGZq2eAxCpiwuamnSC7UgVUkLbuw2XWfqY0cifrK8/

gjyqësore nga politikanë dhe persona të biznesit që kanë një efekt frikësues mbi gazetarët. Politikanët shpesh përdorin gjuhë denigruese për të delegjitimuar gazetarët kritikë". Gjatë muajit dhjetor 2020, janë hedhur në gjyq disa media pas publikimit të artikujve investigues. "*Vetëcensura haset më shumë tek lajmet politike, krimi i organizuar dhe lajmet ekonomike. Interesat politikë dhe ekonomikë të pronarëve të mediave është arsyeja kryesore e vetëcensurës tek gazetarët... Gjatë pandemisë, gazetarët ishin target i dhunës verbale nga politikanët dhe u sanksionuan me gjoba*", thuhet në raport.

Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt në Ballkanin Perëndimor[71] publikoi në Tiranë më 16 korrik 2021, raportin me treguesit mbi nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Shqipëri për vitin 2020. Në raport thuhet se: "*liria e shprehjes, medias dhe informimit, që përmendet në Kushtetutë, nuk zbatohet plotësisht në praktikë, por ka shenja të përkeqësimit të lirisë së shtypit. Shqetësimet për sigurinë e gazetarëve u rritën në vitin 2020, me kërcënime kundër jetës dhe sigurisë fizike e jofizike të tyre, sulme faktike, kërcënime për vrasje dhe sulme ndaj institucioneve të medias, organizatave, mediave dhe shoqatave të gazetarëve.* Në raport theksohet se zyrtarët i dënojnë sulmet ndaj gazetarëve si shkelje e lirisë së shprehjes, por agjencitë e zbatimit të ligjit duhet t'i hetojnë deri në fund këto sulme. Sipas raportit, në proceset gjyqësore gazetarëve shpesh nuk u sigurohet avokat nga media ku punojnë, gjyqet janë shumë të shtrenjta dhe të stërzgjatura. Rrjeti thekson se, në kundërshtim me praktikat më të mira ndërkombëtare, në Shqipëri shpifja konsiderohet kundërvajtje penale. Në vitin 2020 janë regjistruar 12 procese gjyqësore kundër gazetarëve, kryesisht për shpifje. Në disa raste është kërcënuar pavarësia e punës së gazetarëve përmes rritjes së numrit të proceseve gjyqësore kundër tyre, veçanërisht kundër gazetarëve investigativë. Në raport thuhet se "*pavarësia editoriale ndikohet nga lidhjet e ngushta mes mediave, politikës dhe bizneseve, ndërsa vetëcensurimi është i pranishëm. ...*".

Të dhënat e ***Barometrit Kombëtar të Lirisë së Medias në Shqipëri për vitin 2020***[72] konfirmojnë gjendjen e përkeqësuar të lirisë së shprehjes gjatë vitit që lamë pas, të matur në raportet vjetore nga Freedom House dhe Reporterë pa Kufij. Përpjekjet për të imponuar paketën e ashtuquajtur anti-shpifje, lajmet e gatshme nga forcat politike dhe ngjarjet konkrete si, protesta dhe prishja e teatrit kombëtar dhe pandemia përmenden veçanërisht në përgjigje si shenja të përkeqësimit të lirisë. Barometri dëshmon një sërë problemesh që krijojnë një klimë tkurrëse për lirinë e medias në vendin tonë, si pasiguria në punë, mungesa e stabilitetit ekonomik në tregun e punës, mungesa e formalizimit të marrëdhënies së punës apo asaj të ofrimit të shërbimit nëpërmjet kontratave sipas kuadrit ligjor në fuqi, një mjedis të pasigurt me kërcënime dhe ngacmime, censurë dhe vetëcensurë.

Liria e shprehjes dhe situata e medias trajtohet dhe në **Raportin e të Drejtave të Njeriut nga Departamenti i Shteteve të Bashkuara**[73] ku në raportin e vitit 2021 citon se "Unioni i

---

[71] Treguesit mbi nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Shqipëri 2020, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurtë në Ballkanin Perëndimor, 16 korrik 2021, https://safejournalists.net/resources1/albania-indicators-on-the-level-of-media-freedom-and-journalists-safety-in-albania-2020/

[72] Barometri Kombëtar i Lirisë së Medias në Shqipëri, 2020, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Media-2020.pdf?fbclid=IëAR08N1BpXmvPfys3MGgRLpVUU1PSDeCzoPto3N4ZQT95eHnPo7hVciiWOEE

[73] Raporti për të Drejtat e Njeriut, DASH, 2021, Raporte Zyrtare - Ambasada e SHBA në Shqipëri (usembassy.gov)

Gazetarëve Shqiptar (UGSH) raportoi 11 raste të dhunës dhe frikësimit kundër përfaqësuesve të medias, dhe interesat politike dhe të biznesit i nënshtruan presionit ndaj gazetarëve. Gazetarët shpesh praktikonin vetëcensurën për të shmangur dhunën dhe ngacmimet. UGSH shprehu shqetësimin se nga muaji shtator kishte mbi 20 padi kundër gazetarëve, kryesisht për shpifje. Referuar Raporteve të Drejtave të Njeriut nga Departamenti i Shteteve të Bashkuara gjatë periudhës (2015-2021), rezulton se kemi një rritje të çështjeve penale dhe civile me palë gazetarët.

VITI	ÇËSHTJE PENALE DHE CIVILE
2020	11 raste dhune ose intimidimi dhe 20 raste për shpifje ku nuk përjashtohen paditë për shpërblim dëmi
2019	5 raste dhune ose intimidimi dhe 20 raste për shpifje ku nuk përjashtohen paditë për shpërblim dëmi
2018	14 raste intimidimi dhe dhune dhe 16 raste për shpifje ku nuk përjashtohen paditë për shpërblim dëmi
2017	Disa raste dhune dhe intimidimi; 14 raste për shpifje ku nuk përjashtohen paditë për shpërblim dëmi
2016	2 raste për dhunë
2015	Disa raste dhune dhe intimidimi (pa specifikuar numër)

Tabela nr.1: Çështjet penale dhe civile me palë gazetarët gjatë periudhës 2015-2021 sipas Raporteve të Drejtave të Njeriut nga Departamenti i Shteteve të Bashkuara

Në shtator 2020[74] u krijua, me mbështetjen e programit Aleanca Shqiptare për Media Etike, një mekanizëm vetë-rregullimi që po angazhon në mënyrë aktive dhe ndihmon mediat, veçanërisht ato online, në respektimin e Kodit të Etikës të gazetarit.

Sa më sipër, shërben për të kuptuar një panoramë të përgjithshme të situatës mediatike në Shqipëri por dhe çfarë vendi zë liria e shprehjes dhe medias në raportet kombëtare dhe ndërkombëtare.

[74] https://www.coe.int/sq/web/tirana/-/european-union-and-council-of-europe-intensify-support-for-consolidating-key-reforms-to-ensure-justice-fight-corruption-promote-diversity-and-protect-

IV. PREZANTIMI I STUDIMIT MBI ÇËSHTJET GJYQËSORE PENALE DHE CIVILE ME PALË GAZETARË DHE/OSE PËRFAQËSUES TË MEDIAS DHE DATABAZA E HISTORIKUT TË KËTYRE RASTEVE

Qëllimi i këtij studimi është identifikimi, vlerësimi i praktikës gjyqësore në këndvështrimin e standardeve ndërkombëtare si dhe analizimi i dinamikës së çështjeve gjyqësore (penale dhe civile) me palë gazetarë dhe përfaqësues të medias, të shqyrtuara në të tre shkallët e gjyqësorit, gjatë viteve 2020-2021, në kuadër të garantimit të lirisë së shprehjes dhe të medias. Ky studim realizon një fotografim të numrit të çështjeve civile dhe penale me palë gazetarë në të tre shkallët e gjyqësorit si edhe ***krijon për herë të parë një databazë për sa i përket historikut të rasteve me palë gazetarë dhe përfaqësues të medias*** (track-record) duke hedhur dritë mbi mënyrën se si ka evoluar një numër i caktuar çështjesh penale dhe civile nga prokuroria dhe në të 3 shkallët e gjyqësorit. Kështu pas mbledhjes dhe përpunimit të informacionit rezulton se volumin më të madh të materialit statistikor e përbëjnë *të dhënat për gjykatat e rretheve gjyqësore dhe gjykatat e apelit*, duke u përqendruar në natyrën e çështjeve të regjistruara në shkallë vendi, mënyrën e shqyrtimit dhe gjykimit, klasifikimin e çështjeve, afatet e tyre të përfundimit etj.

IV.1 TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET CIVILE DHE PENALE ME PALË GAZETARË TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT E RRETHEVE GJYQËSORE PËR VITET 2020-2021

IV.1.1. Të dhëna statistikore mbi çështjet civile dhe penale me palë gazetarë të shqyrtuara nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore gjatë vitit 2020

- ***Çështjet penale***

Gjykatat e Rretheve Gjyqësore[75], në të cilat janë regjistruar çështje penale me palë gazetarë për veprat penale të parashikuar nga Neni 119 "Fyerja" dhe "Neni 120 "Shpifja" të Kodit Penal, janë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Ndërkohë Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, të cilat nuk kanë pasur raste të regjistrimit të një çështjeje gjyqësore penale janë ato në: Berat; Dibër; Elbasan; Fier; Kavajë; Korçë; Krujë; Kukës; Kurbin; Lezhë; Mat; Përmet; Pogradec; Pukë; Sarandë; Shkodër; Tropojë; Vlorë.

Në gjykatat e shkallës së parë gjatë vitit 2020 janë regjistruar gjithsej 8 çështje penale, të cilat janë çështje të ardhura të reja. Gjeografia e tyre është relativisht e kufizuar, përkatësisht

[75] *Nga 22 Gjykata të Rretheve Gjyqësore* në total *vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk është përfshirë në këtë studim pasi të dhënat e dërguara nga kjo gjykatë nuk evidentonin vetëm rastet, ku palë në procese (civile dhe penale) ishin gazetarët apo përfaqësuesit e medias por ishin të përgjithshme.*

në Tiranë, Gjirokastër dhe Lushnje. Numrin më të madh të çështjeve penale të regjistruara në shkallë vendi e zë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me 5 çështje penale. Çështjet e regjistruara i përkasin veprës penale të parashikuar në Nenin 120 "Shpifja" të Kodit Penal, e cila parashikohet në seksionin e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit. Rezulton se çështje të regjistruara për krime janë 0 dhe ato për kundërvajtje janë 8.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR	ÇËSHTJE PENALE TË REGJISTRUARA	VEPRA PENALE E REGJISTRUAR
Lushnje	1	Neni 120 "Shpifja"
Gjirokastër	2	Neni 120 "Shpifja"
Tiranë	5	Neni 119 "Fyerja" dhe Neni 120 "Shpifja"
T O T A L	8	Neni 119 "Fyerja" dhe Neni 120 "Shpifja"

Tabela nr.2: Numri i çështjeve penale me palë gazetarë dhe veprat penale të regjistruara për vitin 2020 pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore

Nga **8** çështje penale të regjistruara në vitin 2020, janë gjykuar **6** çështje dhe **2** janë ende në proces shqyrtimi. Të shprehur në përqindje, çështjet penale të cilat kanë përfunduar zënë 75 % dhe ato që nuk kanë përfunduar zënë 25 %.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR	GJITHSEJ TË REGJISTRUARA	TË PËRFUNDUARA	TË PAPËRFUNDUARA
Lushnje	1	0	1
Gjirokastër	2	2	1
Tiranë	5	5	0
T O T A L	8	6	2

Tabela nr.3: Çështjet penale të përfunduara kundrejt atyre të papërfunduara gjatë vitit 2020 në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore

Lidhur me shpejtësinë e gjykimit, çështja penale e shqyrtuar ka përfunduar me afat shqyrtimi nga **6 muaj deri në 2 vjet.**

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR	0-6 MUAJ	6 MUAJ - 1 VIT	1-2 VJET	MBI 2 VJET
Gjirokastër	0	0	1	0
Tiranë	1	4	0	0

Tabela nr.4: Shpejtësia e gjykimit të çështjeve penale gjatë vitit 2020 në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore

Për vitin 2020 nga gjykimet e kryera për çështjet penale rezulton 1 i dënuar. Me vendim përfundimtar për vepra penale të kryera sipas Kodit Penal janë gjykuar 5 persona, ndër të cilët 3 janë deklaruar të pafajshëm dhe 1 fajtor.

✓	Me vendim fajësie	1
✓	Me vendim pafajësie	3
✓	Vendosur pushimi i çështjes	1
✓	Vendosur kthimi për plotësim hetimesh	0
✓	Vendosur mos kompetenca	0

- ***Çështjet civile***

Gjykata e Shkallës së Parë, në të cilën janë regjistruar kërkesë padi për shqyrtimin e çështjeve civile me palë gazetarë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë që Gjykatat e Rretheve Gjyqësore të tjera nuk kanë pasur raste të tilla.

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë vitit 2020, janë regjistruar gjithsej 66 çështje civile (ku 39 janë të reja dhe 27 të mbartura). Nga analiza e të dhënave arrijmë në përfundimin se dispozita ligjore kryesore ku qytetarët janë bazuar më së shumti për ngritjen e padive të tyre është Neni 617 "Publikimet mashtruese ose të pasakta" dhe Neni 625 "Përgjegjësia për dëmin jopasuror".

Nga **66** çështje civile të regjistruara në vitin 2020, numri i çështjeve të përfunduara është **14,** ndërkohë **52** janë ende në proces shqyrtimi. Të shprehur në përqindje, çështjet civile të cilat kanë përfunduar zënë *21.2 % dhe ato që nuk kanë përfunduar zënë 78.8%.*

Lidhur me **shpejtësinë e gjykimit**, çështjet civile të shqyrtuar kanë përfunduar me afat shqyrtimi si më poshtë:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR	0-6 MUAJ	6 MUAJ - 1 VIT	1-2 VJET	MBI 2 VJET
Tiranë	6	1	5	2

Tabela nr.5: Shpejtësia e gjykimit të çështjeve civile gjatë vitit 2020 në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore

Për vitin 2020, **mënyra e përfundimit të çështjeve civile me vendime përfundimtare** paraqitet si më poshtë:

✓	Pranuar	1
✓	Pranuar pjesërisht	3
✓	Zgjidhje me pajtim	0
✓	Vendosur pushimi i çështjes	9
✓	Kthim aktesh	1
✓	Vendosur rrëzimin e çështjes	0
✓	Vendosur mos kompetenca	0

IV.1.2. Të dhëna statistikore mbi çështjet civile dhe penale me palë gazetarë të shqyrtuara nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore gjatë vitit 2021

- ***Çështjet penale***

Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, në të cilat janë regjistruar çështje penale me palë gazetarë, për veprat penale të Nenit 120 "Shpifja" dhe Nenit 236 "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik" të Kodit Penal, janë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Ndërkohë Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, të cilat nuk kanë patur raste të regjistrimit të një çështjeje gjyqësore penale janë ato në: Berat; Dibër; Elbasan; Kavajë; Korçë; Krujë; Kukës; Kurbin; Lezhë; Lushnje; Mat; Përmet; Pogradec; Pukë; Sarandë; Shkodër; Tropojë; Vlorë.

Në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, gjatë vitit 2021, janë regjistruar gjithsej **8 çështje penale**. Gjeografia e tyre është relativisht e kufizuar, përkatësisht në Tiranë, Gjirokastër dhe Fier. Çështjet penale të regjistruara i përkasin disa figurave të veprave penale si ato të *Nenit 120 "Shpifja" dhe të Nenit 236 "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik"*. Këto vepra penale parashikohen përkatësisht në seksionet e veprave penale kundër moralit e dinjitetit si dhe kundër veprimtarisë shtetërore. Nga sa më sipër, rezulton se çështje të regjistruara për krime janë **0** dhe ato për kundërvajtje janë **8.**

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR	ÇËSHTJE PENALE TË REGJISTRUARA	VEPRA PENALE E REGJISTRUAR
Tiranë	6	Neni 120 "Shpifja"
Gjirokastër	1	Neni 120 "Shpifja"
Fier	1	Neni 236 "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik"
T O T A L	8	

Tabela nr.6: Numri i çështjeve penale me palë gazetarë dhe veprat penale të regjistruara për vitin 2021 pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore

Nga **8** çështje penale të regjistruara në vitin 2021, janë përfunduar **3** çështje penale dhe **5** janë ende në proces shqyrtimi. Të shprehur në përqindje, çështjet penale të cilat *kanë përfunduar zënë 37.5 % dhe ato që nuk kanë përfunduar zënë 62.5%.*

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR	GJITHSEJ TË REGJISTRUARA	TË PËRFUNDUARA	TË PAPËRFUNDUARA
Tiranë	6	2	4
Gjirokastër	1	0	1
Fier	1	1	0
T O T A L	8	3	5

Tabela nr.7: Çështjet penale të përfunduara kundrejt atyre të papërfunduara gjatë vitit 2021 në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore

Lidhur me **shpejtësinë e gjykimit**, për periudhën **0-6 muaj** është gjykuar 1 çështje, ndërkohë për periudhën **1-2 vite** janë shqyrtuar 2 çështje.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR	0-6 MUAJ	6 MUAJ - 1 VIT	1-2 VJET	MBI 2 VJET
Tiranë	0	0	2	0
Fier	1	0	0	0
T O T A L	1	0	2	0

Tabela nr.8: Shpejtësia e gjykimit të çështjeve penale gjatë vitit 2021 në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore

Për vitin 2021, me vendim përfundimtar janë gjykuar **3** persona, ndër të cilët 2 janë deklaruar të **pafajshëm,** ndërkohë 1 tjetër është deklaruar **fajtor** për kryerjen e veprës penale të parashikuar në Nenin 236 "Kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik"[76]. **Mënyra e përfundimit të çështjeve penale** me vendime gjyqësore përfundimtare paraqitet si më poshtë:

- ✓ Me vendim fajësie 1
- ✓ Me vendim pafajësie 2
- ✓ Vendosur pushimi i çështjes 0
- ✓ Vendosur kthimi për plotësim hetimesh 0
- ✓ Vendosur moskompetenca 0

- ***Çështjet civile***

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, në të cilën është regjistruar çështje penale me palë gazetarë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë Gjykatë, gjatë vitit 2021, janë regjistruar gjithsej 49 çështje civile, prej të cilave 40 janë çështje të mbartura nga 3 mujori i kaluar dhe 9 janë çështje të ardhura të reja. Nga analiza e të dhënave arrijmë në përfundimin se dispozita ligjore kryesore ku qytetarët janë bazuar më së shumti për ngritjen e padive të tyre është *Neni 617 "Publikimet mashtruese ose të pasakta" dhe Neni 625 "Përgjegjësia për dëmin jopasuror" të Kodit Civil*.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR	NENI	NUMRI I ÇËSHTJEVE	PËRQINDJA NDAJ TOTALIT
Tiranë	617 dhe 625	49	100%

Tabela nr.9: Numri i çështjeve civile me palë gazetarë gjatë vitit 2021 dhe objekti i padisë

[76] I dënuari i përket gjinisë mashkullore dhe masa e tij e dënimit është burgim deri në 2 vite.

Nga **49** çështje civile të regjistruara në vitin 2021, numri i çështjeve të përfunduara është **21,** ndërkohë **28** janë ende në proces shqyrtimi. Të shprehur në përqindje, çështjet civile të cilat kanë përfunduar zënë rreth 43 % dhe ato që nuk kanë përfunduar zënë rreth 57 %.

Lidhur me shpejtësinë e gjykimit, çështjet civile të shqyrtuar kanë përfunduar me afat shqyrtimi si më poshtë.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR	0-6 MUAJ	6 MUAJ - 1 VIT	1-2 VJET	MBI 2 VJET
Tiranë	3	2	13	3

Tabela nr.10: Shpejtësia e gjykimit të çështjeve civile gjatë vitit 2021 në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore

Për vitin 2021, **mënyra e përfundimit të çështjeve civile të gjykuara** paraqitet si më poshtë:

- ✓ Pranuar 1
- ✓ Pranuar pjesërisht 3
- ✓ Zgjidhje me pajtim 0
- ✓ Vendosur pushimi i çështjes 12
- ✓ Kthim kërkesë padie 4
- ✓ Vendosur rrëzimin e çështjes 1
- ✓ Vendosur mos kompetenca 0

Nëse do të krahasonim *çështjet penale të regjistruara* dhe statusin e procesit të tyre të gjykimit (të përfunduara /të papërfunduara) në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, për vitet 2020-2021, do të kishim grafikun e mëposhtëm:



Grafik nr.2: Çështjet penale të regjistruara dhe statusi i procesit të tyre të gjykimit (të përfunduara /të papërfunduara) në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, për vitet 2020-2021.

Është e rëndësishme të theksojmë se në Gjykata gjykohen edhe çështje të cilat janë regjistruar në vitet e mëparshme dhe jo domosdoshmërisht gjykimi i tyre ka përfunduar në vitin e regjistrimit të tyre. Gjatë vitit 2020 kanë përfunduar 6 çështje nga 8 të regjistruara kurse gjatë vitit 2021 kanë përfunduar 3 çështje nga 8 të regjistruara. Pra, numri i çështjeve penale të përfunduara gjatë vitit 2020 ka qenë më i madh sesa ai gjatë vitit 2021.

Nëse do të krahasonim *çështjet civile të regjistruara* në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, për vitet 2020-2021, dhe statusin e procesit të tyre të gjykimit (të përfunduara /të papërfunduara), do të kishim grafikun e mëposhtëm:



Grafik nr.3: Çështjet civile të regjistruara dhe statusi i procesit të tyre të gjykimit (të përfunduara /të papërfunduara) në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, për vitet 2020-2021.

Gjatë vitit 2020 kanë përfunduar 14 çështje nga 66 të regjistruara, kurse gjatë vitit 2021 kanë përfunduar 21 çështje nga 49 të regjistruara. Pra, numri i çështjeve civile të përfunduara gjatë vitit 2021 ka qenë më i madh sesa ai gjatë vitit 2020.

IV.2 TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET CIVILE DHE PENALE ME PALË GAZETARË TË SHQYRTUARA NGA GJYKATAT E APELIT PËR VITET 2020-2021

IV.2.1. Të dhëna statistikore mbi çështjet civile dhe penale me palë gazetarë të shqyrtuara nga Gjykatat e Apelit gjatë vitit 2020

- ***Çështjet penale***

Janë regjistruar çështje penale me palë gazetarë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjykatës së Apelit Vlorë dhe Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Ndërkohë Gjykatat e Apelit Shkodër, Durrës dhe Korçë nuk kanë pasur çështje të tilla.

Gjatë vitit 2020, në Gjykatat e Apelit janë regjistruar gjithsej 9 çështje penale, prej të cilave 5 janë çështje të ardhura të reja dhe 4 të mbartura. Çështjet penale të regjistruara i përkasin veprave penale të Nenit 119 "Fyerja"; Nenit 120 "Shpifja"; Nenit 121 "Ndërhyrje të padrejta në jetën private" si dhe Nenit 122 "Përhapja e sekreteve vetjake" të Kodit Penal. Këto vepra penale parashikohen përkatësisht në seksionin e veprave penale kundër moralit e dinjitetit. Nga sa më sipër, rezulton se çështje të regjistruara për krime janë 0 dhe ato për kundërvajtje janë 9.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR	ÇËSHTJE PENALE TË REGJISTRUARA	VEPRA PENALE E REGJISTRUAR
Tiranë	7	Neni 119 "Fyerja", Neni 120 "Shpifja", Neni 121 "Ndërhyrje të padrejta në jetën private", Neni 122 "Përhapja e sekreteve vetjake"
Gjirokastër	1	Neni 120 "Shpifja"
Vlorë	1	Neni 120 "Shpifja"
T O T A L	9	

Tabela nr.11: Numri i çështjeve penale me palë gazetarë dhe veprat penale të regjistruara për vitin 2020 pranë Gjykatave të Apelit

Nga **9** çështje penale të regjistruara në vitin 2020, janë përfunduar **8** çështje penale dhe **1** është ende në proces shqyrtimi. Të shprehur në përqindje, çështjet penale të cilat kanë përfunduar zënë 89 % dhe ato që nuk kanë përfunduar zënë 11 %.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR	GJITHSEJ TË REGJISTRUARA	TË PËRFUNDUARA	TË PAPËRFUNDUARA
Tiranë	7	6	1
Gjirokastër	1	1	0
Vlorë	1	1	0
T O T A L	9	8	1

Tabela nr.12: Çështjet penale të përfunduara kundrejt atyre të papërfunduara gjatë vitit 2020 në Gjykatat e Apelit

Lidhur me shpejtësinë e gjykimit, për periudhën **0-6 muaj** janë gjykuar 2 çështje; për periudhën **1-2 vite** është shqyrtuar 1 çështje tjetër, ndërkohë për periudhën afat shqyrtimi **mbi 2 vjet** kanë përfunduar 5 çështje.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR	0-6 MUAJ	6 MUAJ - 1 VIT	1-2 VJET	MBI 2 VJET
Tiranë	0	0	1	5
Gjirokastër	1	0	0	0
Vlorë	1	0	0	0
T O T A L	2	0	1	5

Tabela nr.12: Shpejtësia e gjykimit të çështjeve penale gjatë vitit 2020 në Gjykatat e Apelit

Për vitin 2020, me vendim përfundimtar janë gjykuar 8 persona, ndër të cilët 4 janë deklaruar të pafajshëm, për 3 persona është vendosur pushimi i çështjes ndërkohë për 1 tjetër është vendosur kthimi i çështjes për plotësim hetimesh. **Mënyra e përfundimit të çështjeve penale** me vendime gjyqësore përfundimtare paraqitet si më poshtë:

- ✓ Me vendim fajësie 0
- ✓ Me vendim pafajësie 4
- ✓ Vendosur pushimi i çështjes 3
- ✓ Vendosur kthimi për plotësim hetimesh 1
- ✓ Vendosur mos kompetenca 0

- ***Çështjet civile***

Gjykata e Apelit, në të cilën janë regjistruar çështje civile me palë gazetarë është Gjykata e Apelit Tiranë. Ndërkohë Gjykatat e tjera të Apelit nuk kanë pasur çështje të tilla në shqyrtim.

Në Gjykatën e Apelit Tiranë, gjatë vitit 2020, janë regjistruar gjithsej **12 çështje civile, prej të cilave 8 janë çështje të mbartura nga 3 mujori i kaluar dhe 4 janë çështje të ardhura të reja.**

Nga analiza e të dhënave arrijmë në përfundimin se dispozitat ligjore kryesore ku qytetarët janë bazuar më së shumti për ngritjen e padive së tyre *janë Neni 617 "Publikimet mashtruese ose të pasakta"; Neni 618 "Përgjegjësia e punëdhënësit"; Neni 625 "Përgjegjësia për dëmin jopasuror"; Neni 640 "Shpërblimi i dëmit" dhe Neni 647/a "Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe të masës së dëmit jopasuror"*.

GJYKATA E APELIT	NENI	NUMRI I ÇËSHTJEVE	PËRQINDJA NDAJ TOTALIT
Tiranë	617	5	42
Tiranë	618	1	8
Tiranë	625	4	34
Tiranë	640	1	8
Tiranë	647/a	1	8

Tabela nr.13: Numri i çështjeve civile me palë gazetarë të regjistruara gjatë vitit 2020 dhe objekti i padisë

Nga **12** çështje civile të regjistruara në vitin 2020, numri i çështjeve të përfunduara është **12,** ndërkohë nuk ka asnjë çështje në proces shqyrtimi.

GJYKATA E APELIT	GJITHSEJ TË REGJISTRUARA	TË PËRFUNDUARA	TË PAPËRFUNDUARA
Tiranë	12	12	0
T O T A L	12	12	0

Tabela nr.14: Çështjet civile të përfunduara kundrejt atyre të papërfunduara gjatë vitit 2020 në Gjykatat e Apelit

Lidhur me shpejtësinë e gjykimit, 6 çështje civile të shqyrtuara kanë përfunduar me afat shqyrtimi **1-2** vjet, ndërsa 6 të tjera me afat shqyrtimi **mbi 2 vite**.

GJYKATA E APELIT	0-6 MUAJ	6 MUAJ - 1 VIT	1-2 VJET	MBI 2 VJET
Tiranë	0	0	6	6

Tabela nr.15 Shpejtësia e gjykimit të çështjeve civile gjatë vitit 2020 në Gjykatat e Apelit

Për vitin 2020, mënyrat kryesore të përfundimit të çështjeve civile të gjykuara janë ato të pranimit dhe të pushimit të tyre, si më poshtë:

- ✓ Pranuar 3
- ✓ Zgjidhje me pajtim 0
- ✓ Vendosur pushimi i çështjes 9
- ✓ Vendosur refuzimi i çështjes 0
- ✓ Vendosur mos kompetenca 0

IV.2.2 Të dhëna statistikore mbi çështjet civile dhe penale me palë gazetarë të shqyrtuara nga Gjykatat e Apelit gjatë vitit 2021

- ***Çështjet penale***

Gjykatat e Apelit, në të cilat janë regjistruar çështje penale me palë gazetarë është **Gjykata e Apelit Tiranë**. Ndërkohë në Gjykatat e tjera nuk janë regjistruar çështje të tilla. Në Gjykatën e Apelit Tiranë, gjatë vitit 2021, është regjistruar gjithsej **1 çështje penale**, e cila është çështje e ardhur e re. Çështja penale e regjistruar i përket veprës penale të parashikuar në **Nenin 120 "Shpifja" të Kodit Penal** (kundërvajtje penale). Për këtë çështje penale të regjistruar në vitin 2021, **është përfunduar gjykimi i saj**, nën periudhën afat shqyrtimi **mbi 2 vjet**. Me vendim përfundimtar është gjykuar 1 person, i cili është deklaruar i pafajshëm.

- ***Çështjet civile***

Gjykata e Apelit në të cilën është regjistruar çështja penale me palë gazetarë është **Gjykata e Apelit Tiranë.** Ndërkohë në Gjykatat e tjera nuk janë regjistruar çështje të tilla. Në këtë Gjykatë, gjatë vitit 2021, janë regjistruar gjithsej **22 çështje civile, prej të cilave 16 janë çështje të mbartura nga 3 mujori i kaluar dhe 6 janë çështje të ardhura të reja.** Nga analiza e të dhënave arrijmë në përfundimin se dispozitat ligjore kryesore ku qytetarët janë bazuar më së shumti për ngritjen e padive të tyre janë **Neni 617 "Publikimet mashtruese ose të pasakta"; Neni 625 "Përgjegjësia për dëmin jo pasuror"; Neni 640 "Shpërblimi i dëmit" dhe Neni 647/a "Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe të masës së dëmit jo pasuror".**

GJYKATA E APELIT	NENI	NUMRI I ÇËSHTJEVE	PËRQINDJA NDAJ TOTALIT
Tiranë	617	6	27
Tiranë	625	7	32
Tiranë	640	5	23
Tiranë	647/a	4	18

Tabela nr.16: Numri i çështjeve civile me palë gazetarë të regjistruara gjatë vitit 2021 dhe objekti i padisë

Nga **22** çështje civile të regjistruara në vitin 2021, numri i çështjeve të përfunduara është **22,** ndërkohë nuk ka asnjë çështje në proces shqyrtimi.

Lidhur me shpejtësinë e gjykimit, 15 çështje civile të shqyrtuara kanë përfunduar me afat shqyrtimi **1-2** vjet, ndërsa 7 të tjera me afat shqyrtimi **mbi 2 vite**.

GJYKATA E APELIT	0-6 MUAJ	6 MUAJ - 1 VIT	1-2 VJET	MBI 2 VJET
Tiranë	0	0	15	7

Tabela nr.17: Shpejtësia e gjykimit të çështjeve civile gjatë vitit 2021 në Gjykatat e Apelit

Për vitin 2021 mënyrat kryesore të përfundimit të çështjeve civile të gjykuara janë ato të pranimit dhe të pushimit të tyre, si më poshtë:

- ✓ Pranuar 18
- ✓ Zgjidhje me pajtim 0
- ✓ Vendosur pushimi i çështjes 4
- ✓ Vendosur refuzimi i çështjes 0
- ✓ Vendosur mos kompetenca 0

Nëse do të krahasonim çështjet penale të regjistruara dhe statusin e procesit të tyre të gjykimit (të përfunduara /të papërfunduara) në Gjykatat e Apelit, për vitet 2020-2021, do të kishim grafikun e mëposhtëm:



Grafik nr.4: Çështjet penale të regjistruara dhe statusi i procesit të tyre të gjykimit (të përfunduara /të papërfunduara) në Gjykatat e Apelit, për vitet 2020-2021.

Nëse do të krahasonim çështjet civile të regjistruara në Gjykatat e Apelit, për vitet 2020-2021, dhe statusin e procesit të tyre të gjykimit (të përfunduara /të papërfunduara), do të kishim grafikun e mëposhtëm:



Grafik nr.5: Çështjet civile të regjistruara dhe statusi i procesit të tyre të gjykimit (të përfunduara /të papërfunduara) në Gjykatat e Apelit, për vitet 2020-2021.

Nëse do të krahasonim sipas viteve (2020-2021) çështjet penale dhe civile sipas statusit të procesit të tyre të gjykimit, në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore; Gjykatat e Apelit dhe Gjykatën e Lartë do të kishim tabelat si vijon:

VITI	GJYKATAT E RRETHEVE GJYQËSORE ÇËSHTJE PENALE		GJYKATAT E APELIT ÇËSHTJE PENALE		GJYKATA E LARTË ÇËSHTJE PENALE
2020	8 regjistruar gjithsej		9 regjistruar gjithsej		0
	2 papërfunduar	6 përfunduar	1 papërfunduar	8 përfunduar	0
2021	8 regjistruar gjithsej		1 regjistruar gjithsej		0
	5 papërfunduar	3 përfunduar	0 papërfunduar	1 përfunduar	0

Tabela nr.18: Çështjet penale sipas statusit të procesit të tyre të gjykimit, në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatën e Lartë për vitet 2020-2021

VITI	GJYKATAT E RRETHEVE GJYQËSORE ÇËSHTJE PENALE		GJYKATAT E APELIT ÇËSHTJE PENALE		GJYKATA E LARTË ÇËSHTJE PENALE
2020	66 regjistruar gjithsej		12 regjistruar gjithsej		1 regjistruar gjithsej
	52 papërfunduar	14 përfunduar	0 papërfunduar	12 përfunduar	1 e papërfunduar
2021	49 regjistruar gjithsej		22 regjistruar gjithsej		1 regjistruar gjithsej
	28 papërfunduar	21 përfunduar	0 papërfunduar	22 përfunduar	1 e papërfunduar

Tabela nr.19: Çështjet civile sipas statusit të procesit të tyre të gjykimit, në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatën e Lartë për vitet 2020-2021

IV.3 KRIJIMI I DATABAZËS SË HISTORIKUT TË ÇËSHTJEVE (PENALE DHE CIVILE) ME PALË GAZETARË DHE/OSE PËRFAQËSUES TË MEDIAS

Duke marrë në konsideratë të dhënat statistikore të mësipërme si dhe rastet e raportuara në media (ku publiku është informuar mbi raste të dhunës ndaj gazetarëve apo përfaqësuesve të medias, intimidim, apo goditje për shkak të detyrës, pjesëmarrje në organizime të paligjshme etj), gjatë viteve 2015-2021, në **Shtojcën I janë paraqitur të dhëna për çështje civile dhe penale me palë gazetarë apo përfaqësues të medias të cilat kanë lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së gazetarëve dhe lirinë e shprehjes së tyre për të raportuar dhe informuar publikun mbi ngjarje të ndryshme** (në vijim "databaza e historikut të të dhënave"). Kjo databazë e historikut të të dhënave na shpjegon se në cilat afate kohore është gjykuar një çështje penale apo civile në të tre shkallët e gjyqësorit, si dhe mënyrën se si ka përfunduar gjykimi i tyre pasi në të është paraqitur dhe dispozitivi i anonimizuar i vendimeve gjyqësore[77].

Nga **42 raste të raportuara në media** për padi penale ndaj gazetarëve apo përfaqësues të medias në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre gjatë viteve 2015-2021, rezulton se: i) **vetëm 13 çështje (ose rreth 31%) ishin regjistruar si çështje penale në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore** (12 në Tiranë dhe 1 në Fier); ii) 2 çështje vazhdonin të ishin në hetim (1 ishte regjistruar në Prokurorinë Tiranë në vitin 2020 dhe tjetra po në Prokurorinë Tiranë gjatë vitit 2021); iii) për 2 çështje ishte vendosur pezullimi nga ana e Prokurorisë; iv) për 2 çështje ishte vendosur mosfillimi i procedimit penal. Ndërkohë që nga 13 çështjet për të cilat është dhënë vendimi në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, vetëm për 8 prej tyre është bërë ankim në Gjykatat e Apelit dhe vetëm për 2 prej tyre është dhënë vendimi në Gjykatën e Apelit (ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë). Ndërkohë, 6 çështje të tjera vazhdojnë të jenë ende në gjykim në Gjykatën e Apelit. Duke analizuar dispozitivin e vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore për çështjet penale, konstatojmë se:

- për 4 çështje është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit dhe në 2 nga këto raste është dhënë dënim me burg: 1 për 1 vit dhe tjetri për 3 muaj. Në këto raste dënimet janë dhënë për veprat penale të parashikuara nga Neni 236/1 i Kodit Penal "Kundërshtimi të punonjësit të policisë së rendit publik" dhe Neni 237 "Goditje për shkak të detyrës" i Kodit Penal.
- për 3 çështje është vendosur deklarimi i pafajshëm i të pandehurve.
- për 6 çështje është vendosur pushimi i çështjes penale.

Në rastet kur është vendosur deklarimi fajtor, vetëm në tre raste i pandehuri është detyruar të publikojë me shpenzimet e veta, vendimin e anonimizuar të Gjykatës.

Ndërkohë për sa i përket çështjeve civile, **rezulton se të 16 rastet e raportuara në media gjatë viteve 2015-2021**, të cilat u morën në studim, ishin regjistruar si çështje civile në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore. Nga studimi dhe kërkimi i informacionit të marrë në të tre shkallët e

[77] Me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve në proces.

gjyqësorit kemi identifikuar, për qëllim të krijimit të databazës së historikut të të dhënave 2015-2021, 65 çështje civile të regjistruara në Gjykata me palë gazetarë apo përfaqësues të medias në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre për informimin e publikut. Shumica e çështjeve janë regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga këto 65 çështje civile të regjistruara në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, rezulton se për 36 çështje ka përfunduar gjykimi ndërsa 29 të tjerat janë ende në gjykim.

Nga 36 çështjet e përfunduara rezulton se mënyra e përfundimit të tyre është si vijon:

- Kthim aktesh – 1;
- Pranim i pjesshëm i padisë - 6 duke u shoqëruar dhe me gjoba e detyrim përgënjeshtrimi apo ndalim publikimi ndaj të paditurve;
- Pushuar - 17 ku nuk mungojnë dhe vendosja e shpërblimit të dëmit moral nga të paditurit në shumat nga 300.000 lekë – 3.500.000 lekë;
- Kthim kërkesë padie – 3;
- Rrëzim padie – 4;
- Pranuar – 5 dhe vendosja e dëmshpërblimeve ndaj të paditurve në shumat nga 50.000 lekë – 1.000.000 lekë e detyrim përgënjeshtrimi apo ndalim publikimi nga të paditurit.

Nga 36 çështje të përfunduara në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, **vetëm 17 prej tyre janë ankimuar në Gjykatat e Apelit** dhe vetëm për 1 nga këto 17 çështje është dhënë vendim. Pra, 16 të tjerat janë ende në gjykim në Gjykatat e Apelit. Nga 17 çështje të cilat janë të regjistruara si në gjykim në Gjykatat e Apelit, vetëm për njërën prej tyre është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila është ende në gjykim. Rasti në fjalë është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2015 dhe në Gjykatën e Lartë në vitin 2018 dhe ende nuk është shqyrtuar.

Pra, kemi një çështje e cila ka kaluar në të tre shkallët e gjykimit në një afat kohor prej 7 vitesh dhe ende nuk ka përfunduar. Kjo vjen dhe si pasojë e mosfunksionimit të Gjykatës së Lartë për rreth 2 vjet për shkak të procesit të rivlerësimit (*vettingut*) dhe stokut të krijuar të çështjeve të pashqyrtuara (civile dhe penale) që gjatë vitit 2021 arriti në nivelin 36.288[78].

Nga analiza e dispozitivit të vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore për çështjet civile, konstatojmë se:

- në rastet për të cilat është vendosur "pushimi i gjykimit", shqyrtimi gjyqësor është kryer në periudhën kohore nga 1-2 vjet.
- në rastet për të cilat është vendosur "kthimi i kërkesëpadisë apo dhe akteve", shqyrtimi gjyqësor është kryer në periudhën kohore nga 1-5 muaj.
- në rastet për të cilat është vendosur "pranimi i padisë apo pranimi i pjesshëm të padisë", shqyrtimi gjyqësor është kryer në periudhën nga 1-2.5 vjet.
- në rastet për të cilat është vendosur "rrëzimi i padisë" shqyrtimi gjyqësor është kryer në periudhën nga 5 muaj – 1 vit.

[78] Raporti vejetor i KLGJ për vitin 2021,fq.37, http://klgj.al/raporti-vjetor-klgj-2021/

Gjobat e vendosura për çështjet civile të analizuara, variojnë në shumat nga 50.000 lekë deri në 3.500.000 lekë duke u shoqëruar kryesisht me detyrimin e të paditurve për të publikuar deklarata përgënjeshtruese apo dhe heqje të lajmeve nga portalet apo dhe ndalimin e publikimit të lajmeve ndaj paditësve.

Gjatë hartimit të databazës së historikut të të dhënave me palë gazetarë apo përfaqësues të medias, kemi konstatuar se jo të gjitha rastet e raportuara në media apo raporte kombëtare e ndërkombëtare materializohen më pas si çështje gjyqësore për gjykim pranë Gjykatave. Ato denoncohen në media apo raporte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare por nuk paraqiten si çështje civile apo penale në gjykata. Këtu mund të përmendim për shembull rastin e Acromax, që në muajin janar 2020 kërcënoi se do të padiste Alice Taylor dhe Exit. al për një hetim që ajo realizoi mbi Partinë Socialiste në Shqipëri, i cili përfshinte heqjen e përmbajtjes kritike nga platformat e mediave sociale, si Facebook dhe YouTube, por në të vërtetë kjo padi nuk u paraqit kurrë në gjykatë.

Gjithashtu, nëse do ti referohemi krahasimit midis databazës së historikut të të dhënave dhe disa rasteve të raportuara nga ***Indeksi i Gazetarëve të Sigurt në Ballkanin Perëndimor për vitin 2021***[79] vërejmë se për 7 shoqërimet e pabazuar në ligj të gazetarëve apo përfaqësuesve të medias nga ana e Policisë së Shtetit gjatë vitit 2020, rezulton se nuk kemi të regjistruar ndonjë padi në gjykatë as nga ana gazetarëve apo përfaqësuesve të medias dhe as nga ana e Policisë së Shtetit. Ndërkohë që për disa çështje kundër gazetarëve rezulton se pavarësisht se është nisur procedimi penal, ky procedim më pas është pezulluar, siç është rasti i sulmit të automjetit të gazetarit Gjergji Figuri në Lezhë, gjatë vitit 2020. Nëse do ti referohemi lajmeve mbi sulmet fizike kundër gazetarëve dhe kërcënimeve serioze ndaj tyre në kuadër të ushtrimit të detyrës së tyre gjatë 3 viteve të fundit, vërejmë se është e vështirë të gjendet informacion për stadin ku çështja është aktualisht. Kjo për shkak se informacioni gjatë fazës së hetimit është konfidencial dhe informacioni lidhur me të dyshuarit disponohet vetëm nga Prokuroria dhe Policia. Këtu mund të përmendim disa raste si: sulmi i shtëpisë së prindërve të gazetares Klodiana Lala (2018); sulmi ndaj gazetarit Elvi Fundo (2017); sulmi i automjetit të gazetarit Gjergji Figuri (2020) etj.[80] Përveç ruajtjes së sekretit hetimor të rasteve të sulmeve kundër gazetarëve apo përfaqësuesve të medias, elementë të cilët ndikojnë në mënyrë të pafavorshme janë: i) procesi i regjistrimit/hedhjes së të dhënave nga ana e prokurorëve të këtyre rasteve dhe ii) mospasja e një udhëzimi specifik për identifikimin dhe hetimin e rasteve me palë gazetarët apo përfaqësuesit e medias.

Databaza do ti kalohet KLGJ dhe MD në përfundim të këtij studimi, si institucionet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave nga sistemi gjyqësor. Informacioni që përmban kjo databazë mund të përdoret për tu pasuruar dhe përditësuar më tej me qëllim identifikimin e çështjeve me palë gazetarë apo përfaqësues të medias, informacion ky i kërkuar dhe nga Komisioni Evropian gjatë takimeve të përbashkëta BE-Shqipëri gjatë viteve 2019-2022.

---

79 https://safejournalists.net/safejournalists-index-tirana/

80 https://safejournalists.net/safejournalists-index-tirana/

IV.4 ANALIZA E TË DHËNAVE TË MBLEDHURA NGA PROCESI I INTERVISTIMIT

Për të kuptuar më shumë mbi arsyet se përse gazetarët apo përfaqësuesit e medias nuk ngrenë çështje penale apo civile në gjykatë kur ju shkelet liria e tyre e shprehjes (në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre), nga zyrtarë, politikanë, biznesmenë, agjencitë e zbatimit të ligjit, qytetarë, etj, u zhvillua një proces intervistimi me gazetarë[81], përfaqësues të institucioneve[82], përfaqësues të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe të Apelit[83] dhe përfaqësues të OSHC-ve të cilat kanë në fushën e tyre të ekspertizës dhe fushën e medias[84]. Ky lloj target grupi u përzgjodh qëllimisht në mënyrë që të kishim një panoramë të qartë dhe sa më gjithëpërfshirëse, të të gjithë aktorëve kryesor në këtë aspekt. Intervistat përfshin një set pyetjesh të përbashkëta për të gjithë target grupet por edhe disa pyetje specifike në rastin e Kuvendit të Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë, KLGJ-së dhe gazetarëve.

Nga përpunimi i të dhënave rezulton se referuar çështjeve gjyqësore, të intervistuarit vënë re një rritje të rasteve me palë "gazetarë" kundër "gazetarëve", përveç padive ku zakonisht kemi palë "politikanë kundër gazetarëve", "përfaqësues të biznesit kundër gazetarëve" apo "policia e shtetit kundër gazetarëve", "zyrtarë kundër gazetarëve".

Rreth 78 % e të intervistuarve mendojnë se "kuadri ligjor në Shqipëri nuk është i mjaftueshëm për të siguruar një mjedis të sigurt për gazetarët", ndërsa 22 % mendojnë se "kuadri ligjor në Shqipëri është i mjaftueshëm për të siguruar një mjedis të sigurt për gazetarët".

88% e të intervistuarve mendojnë se "dënimi me gjobë" është dënimi më efikas në garantimin e lirisë së shprehjes, ndërsa 12% e tyre mendojnë se "dënimi me burg" do të ishte dënimi më efikas në garantimin e lirisë së medias.

Ajo çka bie në sy është fakti se ndër elementët që ndikojnë më negativisht sa i përket mos ngritjes së padive në gjykatë nga ana e gazetarëve janë si vijon:

- 63 % e të intervistuarve shprehen se të gjithë elementët si kohëzgjatja e proceseve gjyqësore, pagesa për shërbime avokatore, tarifa për ngritjen e padisë, statusi i personave ndaj të cilëve mund të ngrihet padia (politikanë, zyrtarë të fuqishëm, biznesmenë të fuqishëm, njerëz të rrezikshëm nga bota e krimit, etj), gjyqtarët dhe praktika gjyqësore ndikojnë negativisht sa i përket mos ngritjes së padive në gjykatë nga ana e gazetarëve;
- 14 % zgjodhën vetëm pozitën e personave ndaj të cilëve ngrihej padia (politikanë, zyrtarë të fuqishëm, biznesmenë të fuqishëm, njerëz të rrezikshëm nga bota e krimit, etj);
- 13 % zgjodhën vetëm kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore;
- 10 % zgjodhën vetëm gjyqtarët dhe praktikën gjyqësore.

---

81 35 gazetarë të intervistuar;

82 MD (3 intervista); KLGJ (1 të intervistuar); Kuvendi i R.SH (2 intervista); Prokuroria e Përgjithshme (4 të intervistuar);

83 16 intervista në 8 Gjykata të Rretheve Gjyqësore dhe 3 intervista në 3 Gjykata të Apelit;

84 10 intervista me përfaqësues të OSHC-ve të cilat kanë në fushën e tyre të ekspertizës dhe fushën e medias.

79 % e të intervistuarve u shprehën se legjislacioni kombëtar dhe standardet ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes dhe të medias nuk zbatoheshin siç duhet nga ana e gjykatave ndërsa 21 % e tyre mendonin që legjislacioni kombëtar dhe standardet ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes së medias zbatoheshin si duhet nga ana e gjykatave.



Grafik nr.6: A zbatohet siç duhet nga ana e gjykatave legjislacioni kombëtar dhe standardet ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes dhe të medias?

Interesant është fakti se pavarësisht nga sa më sipër, 83 % e tyre shpreheshin se ishin po gjykatat ato që ndikonin më shumë në garantimin e lirisë së shprehjes dhe të medias, 15 % shpreheshin se ishin OSHC-të në fushën e medias dhe vetëm 2% e tyre mendonte se ishte Kuvendi, institucioni që ndikonte në garantimin e lirisë së shprehjes dhe të medias.

Rreth 82 % e të intervistuarve identifikuan nevojën për trajnime të gjyqtarëve e prokurorëve sa i përket njohurive të tyre mbi vendimet e GjEDNj si dhe standardeve ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes.

Rreth 66% e të intervistuarve u shprehën se nëse ata do të sugjeronin "një masë për sigurimin e lirisë së shprehjes dhe medias në Shqipëri" ajo do të ishte "masë zbatuese" dhe vetëm 34 % e tyre u shpreh se do të sugjeronin një "masë ligjore". Ndërkohë që të pyetur "nëse do të kishit mundësi të sugjeronit një masë ligjore për sigurimin e lirisë së shprehjes dhe medias në Shqipëri ajo do të ishte?", rreth 55% e të intervistuarve u shprehën se kjo masë do të ishte "ndryshim i llojit të dënimit" (p.sh. "forcim të dënimit me burg" ose "rritje të gjobës së dhënë"), 13 % u shprehën se do të sugjeronin ndryshim të procedurave/afateve për procesin civil ndaj cënuesve të lirisë së shprehjes së medias dhe 32 % u shprehën se do të sugjeronin ndryshim të procedurave/afateve për procedimin penal ndaj cenuesve të lirisë së shprehjes së medias.

Pyetjes se cilët nga kategoritë e personave të mëposhtëm cenojnë lirinë e shprehjes dhe të medias në Shqipëri, të intervistuarit janë përgjigjur sipas grafikut të mëposhtëm:



Grafiku nr.7: Cilët nga kategoritë e personave të mëposhtëm cenojnë lirinë e shprehjes së medias në Shipëri?

Gjatë 3 viteve të fundit nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore pranë Komisionit Parlamentar të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik me gazetarë apo OSHC, lidhur me çështjet gjyqësore (penale apo civile) të ngritura nga/ apo kundër gazetarëve dhe/apo përfaqësueseve të medias, në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Pyetjes drejtuar gazetarëve, në kanë ngritur ndonjëherë çështje penale ndaj institucioneve apo individëve që nuk janë përfaqësues të shtetit si rezultat i pasojave që mund të kenë ardhur për shkak të ushtrimit të detyrës si gazetar, 94% e tyre i janë përgjigjur jo, 3% i është përgjigjur "po ndaj përfaqësuesve të institucioneve" dhe 3% prej tyre i është përgjigjur "po ndaj individëve që nuk janë përfaqësues të institucioneve". Këto çështje janë paraqitur në gjykatë gjatë viteve 2019-2020 për veprat penale të "Shpifjes" dhe "Kanosjes" dhe kanë përfunduar me vendim për pushimin e çështjes dhe me vendim fajësie.

Pyetjes drejtuar gazetarëve, në kanë ngritur ndonjëherë çështje civile ndaj institucioneve apo individëve që nuk janë përfaqësues të shtetit si rezultat i pasojave që mund të kenë ardhur për shkak të ushtrimit të detyrës tuaj si gazetar, 94% e tyre i janë përgjigjur jo, 3% i është përgjigjur "po ndaj përfaqësuesve të institucioneve" dhe 3% prej tyre i është përgjigjur "po ndaj individëve që nuk janë përfaqësues të institucioneve". Këto çështje janë paraqitur në gjykatë gjatë viteve 2019-2020.

Pyetjes drejtuar gazetarëve në është ngritur ndonjëherë çështje penale ndaj tyre si rezultat i pasojave që mund të kenë ardhur për shkak të ushtrimit të detyrës si gazetar, 97% prej tyre i është përgjigjur jo ndërkohë që 3% i është përgjigjur "Po"[85].

[85] Para vitit 2015 për veprën penale të "Shpifjes";

IV.5 ANALIZË E VENDIMEVE TË GJYKATAVE

Në përputhje me metodologjinë u analizua praktika gjyqësore dhe të dhënat e databazës së historikut të çështjeve gjyqësore me palë gazetarë dhe përfaqësues të medias për rreth 30 çështje penale dhe civile. Në rastet e arsyetimeve të vendimeve gjyqësore të cilat vendosin: *"rrëzimin e padisë", "kthimin e kërkesë padisë", "kthimin e akteve" apo "pushimin e çështjes"* nuk ka ndonjë referencë sa i përket legjislacionit ndërkombëtar apo standardeve ndërkombëtare për lirinë e shprehjes dhe të medias por referim tek legjislacioni i brendshëm.

Në rastet e *"pranimit të padive"* apo *"pranimit të pjesshëm të tyre"* disa gjyqtarë, në arsyetimin e vendimeve gjyqësore të viteve të fundit, i janë referuar standardeve ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes dhe të medias (kryesisht vendimeve të GjEDNj). Gjobat e vendosura nga këto vendime variojnë nga 50.000 lekë deri në 3.500.000 lekë. Arsyeja pse ka shumë diferencë në shumën e përcaktuar të dëmshpërblimit nga çështja në çështje, është fakti se shuma e dëmshpërblimit përcaktohet në zbatim të **Vendimit Unifikues nr.10, datë: 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë**. Ky vendim parashikon se "*Shuma e dëmshpërblimit për dëmin moral, për shkak të natyrës subjektive dhe të brendshme të tij, nuk mund të llogaritet mbi tabela dhe skema të parallogaritura vetëm për këtë qëllim. Prandaj, gjykata e cakton atë mbështetur në parimin e dhënies së drejtësisë sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre, duke u mbështetur edhe në kritere eventuale normative të zbatueshme sipas natyrës së të drejtës së cenuar ose, në mungesë të tyre, në kritere dhe elementë vlerësimi të konsoliduar nga praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve analoge ose në përvoja përkatëse jashtëgjyqësore, duke pasur gjithnjë parasysh zhvillimin aktual ekonomik e social të vendit, përfshirë vlerën e parasë në ekonominë kombëtare*." Në të gjitha vendimet gjyqësore të "*pranimit të padisë*" dhe *"pranimit të pjesshëm të padisë"* është vendosur edhe *"detyrimi i të paditurit për të përgënjeshtruar lajmet për paditësin apo dhe heqjen e këtyre lajmeve nga portalet".*

Nëse do ti referohemi databazës së historikut të të dhënave me palë gazetarë apo përfaqësues të medias, rezulton se në 65 padi civile dhe 13 penale të ngritura kundër gazetarëve apo përfaqësuesve të medias, gati 60 % e tyre janë ngritur nga politikanë, biznesmenë apo përfaqësues institucionesh kundër gazetarëve apo përfaqësuesve të medias. Ndërmjet këtyre rasteve, ka padi të cilat zgjasin prej më shumë se 2 apo 3 vitesh dhe janë ende në proces, të cilat sjellin kosto të shtuara për gazetarët referuar pagesave që ju bëjnë avokatëve për mbrojtjen e tyre.

Sjellim në vëmendje se një pjesë prej këtyre padive, i përkasin dhe padive që akademikët i quajnë "padi Slapping"[86] ose ndryshe "Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike". Paditë civile apo akuzat penale të ngritura nga politikanët dhe biznesmenët ndaj gazetarëve

[86] https://www.ecpmf.eu/slapp-the-background-of-strategic-laësuits-against-public-participation/ Në vitet 1980, dy akademikë amerikanë shkruan një libër me titull: *Slapps: Getting Sued For Speaking Out* (Slapps: Të të hedhin në gjyq sepse ke folur), ku përshkruan se si në historinë e Amerikës, të famshmit, të fuqishmit dhe të pasurit, individë apo korporata, kanë abuzuar me të drejtën për të ngritur padi në gjykatë me synimin e shtyrjes së kritikëve drejt heshtjes.

apo qoftë edhe vetëm kërcënimet për padi apo akuza, kanë gjithashtu edhe efektin negativ në imazh, pasi vetë akuza për "shpifje" përbën një sulm verbal, në të cilin politikani apo biznesmeni përdor fuqinë e tij mediatike për të sulmuar një gazetar, që nuk ka të njëjtën fuqi mediatike. Këtu mund të përmendim si shembull padinë e ngritur referuar partneritetit publik privat për inceneratorin në Elbasan (Kompania Albtek Energy kundër Artan Rama gjatë vitit 2020[87]), padinë e Edil.al kundër Artan Rama gjatë vitit 2016[88], Mirel Mërtiri kundër BIRN[89], etj.

Nga 30 vendime penale dhe civile, për të cilat kemi gjetur tekstet e vendimeve (këtu përfshihen dhe ato vendime gjyqësore, të cilat kanë vendosur pushimin, rrëzimin e padisë apo kthimin e akteve për plotësim) më poshtë gjeni në mënyrë të përmbledhur 3 vendime (dy civile dhe 1 penale) me palë gazetarë apo përfaqësues të medias, për të cilat nga ana e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore është vendosur "pranimi" ose "pranimin e pjesshëm" për çështjet civile dhe "deklarimi i pafajshëm i gazetarit" për çështjen penale. Këto çështje janë analizuar në raport me standardet e përcaktuara nga GjEDNj për rastet e ngjashme.

Në çështjen civile *"C. kundër J."* nga paditësi kërkohej "shpërblim dëmi jopasuror si dhe detyrimin për të publikuar një përgënjeshtrim në një portal X në internet, të akuzave të rreme ndaj paditësit (i cili ishte përmendur me emër dhe mbiemër në shkrim) duke fshirë njëkohësisht nga arkivi i portalit të sipërpërmendur artikullin "shpifës" të publikuar në vitin 2016. Gjykata në vitin 2018 ka vendosur "*pranimin pjesërisht të padisë dhe dënimin e të paditurit për të shpërblyer paditësin C. në shumën 300.000 lekë, për dëmin jopasuror të shkaktuar nga publikimi në portalin X si dhe detyrimin e të paditurit të publikoj përgënjeshtrimin e artikullit në të njëjtën formë dhe mënyrë të përdorur me publikimin e shkrimit dhe transmetimit të informacionit të rremë në portalin X vetëm për sa i përket paditësit*". Referuar këtij rasti vërejmë që GjEDNj[90] në disa vendime thekson se "*fakti i të akuzuarit direkt të individëve të veçantë, duke përmendur emrat dhe pozicionet e tyre, i vendos aplikantët nën detyrimin për të siguruar një bazë faktike të mjaftueshme për pohimet e tyre*."

Në të njëjtën linjë me sa më sipër është dhe çështja civile *"R kundër Xh"* me objekt: "shpërblim dëmi jopasuror si dhe detyrimin për të publikuar një përgënjeshtrim në një portal X në internet, të akuzave të rreme ndaj paditësit (i cili ishte përmendur me emër dhe mbiemër në shkrim)". Edhe në këtë rast gjykata ka vendosur: "*pranimin pjesërisht të padisë dhe dënimin e të paditurit për të shpërblyer paditësin R në shumën 100.000 lekë, për dëmin jopasuror të shkaktuar nga publikimi në portalin X si dhe detyrimin e të paditurit të publikoj përgënjeshtrimin e artikullit në të njëjtën formë dhe mënyrë të përdorur me publikimin e shkrimit dhe transmetimit të informacionit të rremë në portalin X vetëm për sa i përket paditësit*". Nëse i referohemi standardeve evropiane të përcaktuara në Vendimin e GjEDNj

87 https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2021/07/AL-AL-2020.pdf

88 https://faktoje.al/padite-ne-gjykata-dredhia-e-te-pushtetshmeve-per-te-penguar-te-verteten/

89 https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2021/07/AL-AL-2020.pdf

90 GjEDNj, Cumpana dhe Mazare kundër Rumanisë (2004) https://hudoc.echr.coe.int/tur#{%22itemid%22:[%22001-67816%22]}

"Ligens kundër Austrisë"[91] ku bëhet dallimi midis "deklaratave të faktit" dhe "gjykimeve vlerësuese" kjo gjykatë shprehet: "*se edhe nëse një deklaratë përbën një gjykim vlerësues (opinion), përpjestimi i ndërhyrjes mund të varet nga fakti nëse ekziston ose jo një bazë të mjaftueshme faktike për deklaratën e kundërshtuar, për shkak se edhe një gjykim vlerësues, pa asnjë bazë faktike që e mbështet atë, mund të jetë i tepërt*".

Në çështjen penale "*Agjensia A dhe P kundër të akuzuarit S e M"*, paditësi kërkon "Deklarimin fajtor të të akuzuarit S, për konsumimin e kundërvajtjes penale "Fyerja" e kryer botërisht parashikuar nga neni 119/2 dhe 120/2 të Kodit Penal dhe dënimin me gjobë si dhe detyrimin e të akuzuarit që të publikojë me shpenzimet e tij në faqen e parë të gazetave "Panorama", "Shqiptarja.com", "Gazeta Shqiptare" si dhe edicionin qendror të lajmeve në kanalin televiziv "FAX NEWS", vendimin gjyqësor penal që do të dalë për këtë çështje gjyqësore". Në këtë rast përfaqësuesit e medias, të thirrur në një emision kishin dhënë opinionet e tyre mbi tematikën e diskutuar mbi shkeljen e të drejtave të autorit. Gjykata vendosi deklarimin e pafajshëm të të padituri. Në të njëjtën linjë është dhe praktika e GjEDNj, e cila në çështjen Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë [92]shprehet se "*Për të vlerësuar provat e faktit, Gjykata adopton standardin e të provuarit "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm", por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkë-ekzistenca e deduktimeve përkuese, mjaftueshmërisht të fortë dhe të qartë ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit*." Në rastin në fjalë paditësi nuk arriti të provojë se i padituri S kishte kryer veprat penale për të cilat akuzohej.

Nga studimi i vendimeve të databazës por në të njëjtën kohë edhe nga kërkimi i realizuar në media (të shkruar dhe asaj online), që përkon me kohën e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore të marra në shqyrtim, vlerësojmë se ka pasur intimidime dhe vetëcensurë të gazetarëve apo përfaqësuesve të medias, kundër të cilëve janë ngritur padi penale apo civile.

[91] GjEDNj, Ligens kundër Austrisë, https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:[%22001-57523%22]}

[92] GjEDNj, Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë, https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22dmdocnumber%22:[%22853404%22],%22itemid%22:[%22001-93948%22]}

V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Referuar studimit të mësipërm, por duke u bazuar dhe në shqetësimin që ngrenë raportet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e lirisë së medias në Shqipëri, më poshtë paraqiten disa rekomandime që kanë për qëllim "*garantimin e lirisë së shprehjes dhe të medias*":

- Mbledhja e të dhënave për gazetarët dhe/apo përfaqësuesit e medias, është shumë e rëndësishme pasi na tregon realisht se sa shqetësues është problemi me garantimin e lirisë së shprehjes së medias në Shqipëri. Edhe pse Komisioni Evropian[93] ka kërkuar në mënyrë të përsëritur të dhëna për "sulmet dhe dhunën kundër gazetarëve", institucionet shqiptare nuk publikojnë të dhëna për kërcënimet dhe/apo sulmet ndaj gazetarëve apo padive që ngrihen si: shpifja, fyerja, shpërblim dëmi jo pasuror, goditje për shkak të detyrës, kanosje, etj, si dhe të dhëna mbi mënyrën se si janë trajtuar këto raste. Rezulton se institucione të ndryshme të drejtësisë, si gjykatat dhe prokuroria, i regjistrojnë të dhënat e tyre përmes sistemeve të ndryshme të teknologjisë së informacionit[94] në të cilët të dhënat që regjistrohen apo metodologjia e ndjekur për regjistrimin e tyre, janë të ndryshme. Rrjedhimisht dhe përpunimi i të dhënave mbi çështjet gjyqësore civile apo penale me palë gazetarët apo përfaqësues të medias nga MD dhe KLGJ bëhet i vështirë. *Me qëllim për të garantuar lirinë e shprehjes së gazetarëve por dhe për të pasur një vijimësi në përpunimin dhe publikimin e një informacioni të tillë, vlerësojmë se është e domosdoshme që të dhëna të tilla statistikore të sigurohen nëpërmjet një identifikimi specifik nga Policia, Prokuroria dhe Gjykatat, respektivisht për hetimin, procedimin dhe shqyrtimin gjyqësor të çështjeve civile dhe penale me palë gazetarë ose përfaqësues të medias, të cilat ngrihen si rezultat i të ushtrimit të veprimtarisë së tyre*. Aktualisht, Gjykatat bëjnë një identifikim specifik për çështje të caktuara si për shembull, mbajnë evidenca statistikore për: "dhunën në familje", për "çështjet penale me të mitur", etj. E njëjta gjë mund të aplikohet dhe për të dhënat lidhur me çështjet penale dhe civile me palë gazetarë apo përfaqësues të medias. *Për adresimin e këtij rekomandimi, mund të ngrihet një grupi ndërinstitucional pune në të cilin anëtarë të jenë pikërisht përfaqësues nga institucionet e sipërpërmendura. Ky grup pune do të vlerësojë se cila do të ishte mënyra më e mirë e identifikimit të këtyre çështjeve dhe të dhënat që duhen mbledhur.*

[93] Gjatë nën-komiteteve të BE-Shqipëri të Drejtësisë Lirisë dhe Sigurisë / një nga strukturat e ngritura në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit /MSA (viti 2019 dhe 2021).

[94] Prej vitit 2005, në gjykatat shqiptare operojnë dy sisteme të ndryshme elektronike për ndarjen e çështjeve gjyqësore dhe ecurinë e zhvillimit të tyre (ARK-IT dhe ICMIS). Aktualisht sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore (civile, penale dhe administrative) është funksional në të gjitha gjykatat e vendit, përfshirë Gjykatën e Lartë. Përjashtim nga aplikimi i këtij sistemi (ICMIS) bën vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ndërkohë që Prokuroria përdor sistemin (CAMS).

- Për të mbrojtur ushtrimin e lirisë së shprehjes së gazetarëve dhe/ose përfaqësuesve të medias, sugjerojmë që televizionet/portalet/mediat e shkruara për të cilët gazetarët punojnë si dhe OSHC-të dhe Shoqatat e Gazetarëve, të mund të ofrojnë ndihmë ligjore falas gjatë të gjitha fazave që nga ndalimi/arrestimi nga Policia, gjatë hetimit dhe më pas në procesin gjyqësor. Gjithashtu, nuk duhet harruar apo neglizhuar edhe mbështetja psikologjike që i duhet ofruar gazetarëve në rastet e kanosjeve dhe/apo dhunës për shkak të detyrës.

- Të sigurohen trajnime të vazhdueshme për Policinë e Shtetit/Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Akademinë e Policisë se si duhet të trajtohen gazetarët në kuadër të ushtrimit të detyrës së tyre për garantimin e lirisë së shprehjes dhe të medias në një shtet demokratik, duke përfshirë këtu edhe mënyrën se si të sigurohet që gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias të jenë në gjendje të veprojnë në mënyrë të sigurt dhe pa kufizime gjatë tubimeve publike, protestave dhe demonstratave. Pjesë e kurrikulës së këtyre trajnimeve duhet të jenë dhe vendimet e GjEDNj për të kuptuar më mirë, standardet evropiane në këtë aspekt.

- Të hartohen "procedura standarde të veprimit" nga Policia e Shtetit mbi mënyrën se si duhet të trajtohen gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, që të jenë në gjendje të veprojnë në mënyrë të sigurt dhe pa kufizime, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë, trajtimit të tyre gjatë tubimeve publike, protestave dhe demonstratave. Kjo me qëllim për të përmirësuar kapacitetet e Policisë së Shtetit në garantimin e sigurisë publike por duke mbrojtur të drejtat e gazetarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre;

- Të hartohen "protokolle specifike hetimore", për të siguruar zbulimin dhe ndjekjen efikase të sulmeve dhe/apo dhunës kundër gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias me qëllim jo vetë zbardhjen dhe dënimin e autorëve, por dhe garantimin në praktikë të lirisë së shprehjes së medias.

- Edhe pse ekziston një temë në programin e trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës[95] për vitin 2021, duke u bazuar në intervistat e realizuara, vlerësojmë se ky trajnim është i pamjaftueshëm duke parë këtu dhe jurisprudencën e larmishme të GjEDNj për lirinë e shprehjes dhe të medias. *Për këtë qëllim, sugjerojmë që të sigurohen trajnime të vazhdueshme periodike, për prokurorët dhe gjyqtarët mbi vendimet e GjEDNj sa i përket garantimit të lirisë së shprehjes dhe të medias, në mënyrë që të kemi një njohje më të mirë dhe ndërgjegjësim të shtuar mbi praktikën evropiane në këtë fushë si gjatë fazës së hetimit ashtu dhe gjatë gjykimit, të çështjeve me palë gazetarë.*

[95] https://www.magjistratura.edu.al/sq/programi-i-trajnimeve

- Të sigurohen trajnime të vazhdueshme për gazetarët e rinj dhe për studentët e Fakultetit të Gazetarisë sa i përket standardeve ndërkombëtare mbi lirinë e shprehjes dhe të medias, ku një pjesë e kurrikulës ti dedikohet edhe respektimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, mbrojtjes së të dhënave personale, respektimit të Kodit të Etikës, etj.

- Të sigurohet zbatimi i dispozitave ligjore për lirinë e shprehjes dhe të medias si nga ana e pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor në përputhje me standardet ndërkombëtare duke garantuar në praktikë, zbatimin e një politike të tolerancës zero për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve, si dhe për kërcënimet ndaj medias, përfshirë këtu edhe diskutimet në debatin politik.Të rriten fushatat e ndërgjegjësimit nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj vizive për sa i përket rolit dhe rëndësisë së punës së gazetarëve si dhe lirisë së tyre për t'u shprehur duke siguruar kështu dhe një rritje të ndërgjegjësimit të gjithë opinionit publik në lidhje me këtë temë. Është e rëndësishme që çdokush të kuptojë që garantimi i lirisë së shprehjes për median, do të thotë më shumë transparencë mbi qeverisjen dhe ata që na qeverisin, më shumë transparencë mbi gjyqësorin dhe ata që na gjykojnë dhe më shumë transparencë mbi legjislativin dhe ligjet që ata miratojnë.

- Dhe së fundmi, theksojmë se çdo iniciativë ligjore, e cila prek fushën e lirisë së shprehjes dhe të medias duhet të konsultohet domosdoshmërisht me të gjithë palët e interesit, që në fillim të ndërmarrjes së iniciativës dhe më pas në çdo fazë të procesit të diskutimit dhe miratimit në qeveri dhe në Kuvendin e Shqipërisë.

SHTOJCA I: Databaza e anonimizuar

Çështjet civile

Nr.	Palët	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Data e regjistrimit/ Numri Akti	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Numri i Vendimit/ Data e vendimit	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vendimi/Dispozitivi	Gjykata e Apelit Data e regjistrimit/ Numri i aktit	Gjykata e Apelit Numri i Vendimit/ Data e vendimit	Gjykata e Apelit Vendimi/ Dispozitivi	Gjykata e Lartë Data e Vendimit Numër i çështjes Vendimi/ dispozitivi
1	M.P kundër Th.S	Nr. 895 Dt. 14.01.2014	Nr. 4794 Dt. 09.06.2015	VENDOSI: -Pushimin e gjykimit të çështjes civile me Nr .895 Akti. -Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të paditësit. -Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve për palët prezente dhe për palën paditëse në mungesë afati fillon nga dita e marrjes për dijeni të vendimit. Shpallur më datë 09.06.2015.				
2	S.B kundër "L..... shpk"	Nr. 9811 Dt. 23.06.2015	Nr. 7756 Dt. 15.10.2015	VENDOSI: -Pranimin e kërkesë-padisë. -Detyrimin e palës së paditur për të ndaluar publikimet dhe heqjen e materialeve të publikuara në të gjitha formatet të cilat janë cenuese të jetës private të paditësit. -Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur. -Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e shpalljes së tij për palën prezente dhe nga e nesërmja e ditës së komunikimit të				

				vendimit për palën e paditur dhe L... në mungesë. Shpallur më datë 15.10. 2015.				
3	M.V kundër portalit online mediatik "L...." në pronësinë, A.Sh dhe A.B	Nr. 2259 Dt. 15.09.2015	Nr. 1035 Dt. 15.02.2016	VENDOSI: -Rrëzimin e kërkesë-padisë së paditësit M.V. -Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse. -Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit për palën paditëse prezent, dhe nga dita e nesërme e marrjes dijeni për palët e paditura në mungesë. Shpallur më datë 15.02.2016.	3883 akti/ 14.04.2016,	Nr. 2299 Dt. 25.10.2017	Kundër këtij vendimi është bërë ankim dhe aktet i janë dër-guar Gjykatës së Apelit, e cila me vendimin Nr.2299 datë 25.10.2017, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit Nr.1035 datë 15.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër vendimit, lejo-het rekurs në Gjykatën e Lartë. Tiranë, më datë 15.11.2017.	Datë e De-pozitimit: 16 .01.2018 Dorëzuesi: M.V Nr. i çështjes: 11118-00202-00-2018
4	C.B kundër S.B	Nr. 769 Dt. 28.09.2016	Nr. 3286 Dt. 11.04.2018	VENDOSI: -Pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë. -Detyrimin e palës së paditur që ti paguaj paditësit shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë si dëmshpërblim për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar. -Rrëzimin e kërkimeve të tjera të padisë. -Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur. -Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e	Ankimuar , Nr 455 akti/ 21.06.2018 Nr. 1815			

				nesërmja e shpalljes së vendimit, dhe për paditësen ky afat fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit. Shpallur më datë 11.04.2018.				
5	Gj.Gj kundër E.Q dhe A.D ("Sh……. sh.p.k	Nr. 1634 Dt. 22.05.2017	Nr. 2675 Dt. 23.3.2018	VENDOSI: -Pushimin e gjykimit të çështjes civile me Nr.1634 Akti, me paditës Gj.Gj dhe E.C , të paditur Shoqëria "Sh…….sh.p.k, etj, me objekt "Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Sh……"sh.p.k. të dëmshpërblejë paditësit për dëmin jopasuror të pësuar prej cenimit të nderit dhe personalitetit në vlerën 2.000.000 lekë. -Detyrimin e palës së paditur Shoqëria ""Sh…….sh.p.k të përgënjeshtrojë me shpenzimet e veta në gazetën "Sh…….sh.p.k vendimin e Gjykatës. Detyrimin e palës së paditur E.Q të dëmshpërblejë paditësit për dëmin jopasuror të pësuar prej cenimit të nderit dhe personalitetit në vlerën 1.000.000 lekë. -Detyrimin e palës së paditur A.D të dëmshpërblejë paditësit për dëmin jopasuror të pësuar prej cenimit të nderit dhe personalitetit në vlerën 1.000.000 lekë"." Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë. " Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5(pesë) ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. -Për palën në mungesë afati fillon nga dita e marrjes dijeni. Shpallur më datë 23.03.2018.				

6	U.H kundër N..... al , "Sh.....sh.p.k	Nr.382, dt. 23.03.2017	Në Gjykim		Nr.2001 Akti, date 13.10.2017			
7	P.F kundër S.K	Nr.12395 Dt.26.09.2019	Nr.8308 Dt 12.12.2019	VENDOSI: Bazuar në nenin 179 paragrafi 1 dhe 2 të K.Pr.Civile: - Pushimin e gjykimit të çështjes civile me Nr.12395 Akti, datë:26.09.2019. - Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse. - Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë, brenda 5(pesë) ditëve, në Gjykatën e Apelit Tiranë, afat ky që fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Shpallur më datë 12.12.2019	Ankimuar Nr. 2498 akti / 06.02.2020			Vendimi Nr. 136, dt. 03.06.2020 Mospranimin e ankimit të bërë nga pala e paditur G.Z dhe S.K, kundër vendimit të ndërm-jetëm datë 27.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elba-san.
8	P.F kundër S.K dhe G.Z	Nr. 2013/492, dt. 20.07.2018	Vendim i ndërmjetëm dt. 27.03.2019	VENDOSI: - Gjykata e Rrethit Elbasan me vendimin e ndërmjetëm dt. 27.03.2019 vendosi: . Rrëzimin e kërkesës së të padituritit S.K dhe G.Z për shpalljen e mos kompetencës tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për çështjen civile me Nr. 2013/492 regj. them, datë 20.07.2018.	Nr. 2498 Akti, 28.04.2019	Në datë 28.04.2019 ka ushtruar ankim të veçantë pala e padi-tur S.K dhe G.Z.		
9	A.D kundër Shoqëria TV K...sha	Nr. 960, datë 20.12.2018	Në Gjykim					

10	E....al kundër A.R	Nr. 4274, datë 17.11.2016	Nr. 10.086 Dt. 30.11.2017	VENDOSI: -Rrëzimin e kërkesë-padisë. -Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse. -Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Për palët në mungesë ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit. Shpallur më datë 30.11.2017.	4921 akti/ 10.09.2018			
11	C.B kundër J.O	viti 2016	Nr. 1750 Dt. 27.02.2018	VENDOSI: -Gjykata bazuar në nenin 126-306 të Kodit të Procedures Civile vendosi: Pranimin pjesërisht të padisë të paditësit C.B. -Detyrimin e të paditurit J.O për të shpërblyer paditësin C.B në shumën 300.000 lekë, për dëmin jopasuror të shkaktuar nga publikimi në portalin b.....al në dt.17.10.2016 i artikullit me titull "L.E dhe K.B". -Detyrimin e të paditurit J.O të publikojë përgënjeshtrimin e artikullit në të njëjtën formë dhe mënyrë të përdorur me publikimin e shkrimit dhe transmetimit të informacionit të rremë në portalin b.....,vetëm për sa i përket paditësit, me marrjen e vendimit formë të prerë. -Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë. -Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur në raport me masën e pranuar të padisë. -Kundër vendimit lejohet ankim në gjykatën e Apelit Tiranë sipas afatit ligjore. U shpall në Tiranë më datë 27.02.2018.				

12	B. Çollaku kundër T.B	Nr. 1077 Dt. 15.10.2018	Nr. 4186 Dt. 12.10.2020	VENDOSI: -Pranimin e kërkesë-padisë si më poshtë: -Detyrimin e palës së paditur, T.B të dëmshpërblejë palën paditëse B.Ç me vlerën 200.000,00 (dyqind mijë) lekë për dëmin jopasuror, dëm moral, shkaktuar nga deklarimi i datës 27.09.2018 në emisionin 'O...' në TV K..... -Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të saj. -Ky vendim është i ekzekutueshëm nga përmbaruesit gjyqësor. -Shpenzimet gjyqësore të padisë i ngarkohen palës së paditur në masën e padisë të pranuar nga gjykata. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve. Shpallur më datë 12.10.2020.				
13	E.R kundër Y.R	Nr. 1659 Dt. 17.06.2019	Nr. 3247 Dt. 17.05.2021	VENDOSI: -Pushimin e gjykimit të çështjes civile Nr.Regj.Them 9902/2745/1659, datë regjistrimi 17.06.2019, që i përket paditësit E.R, kundër palës së padituri Y.R. -Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse. -Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar. Shpallur më datë 17.05.2021.				

14	E.R kundër Y.R	Nr. 1058 Dt. 30.01.2019	Nr. 3242 Dt. 17.05.2021	VENDOSI: -Pushimin e gjykimit të çështjes civile me Nr.1058 Akti me palë paditëse E.R dhe palë të paditur Y.R. -Pushimin e gjykimit për kundër-padinë e paraqitur nga i padituri kundër-paditës Y.R dhe palë paditëse kundër-paditur E.R. -Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë. -Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë brenda 5 ditëve, në Gjykatën e Apelit Tiranë, afat ky që fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Shpallur më datë 17.05.2021.				
15	Y.R kundër E.R	Nr. 1501, dt 30.01.2019	Nr. 3242 Dt. 17.05.2021	VENDOSI: -Pushimin e gjykimit të çështjes civile me Nr.1058 Akti me palë paditëse E.R dhe palë të paditur Y.R. -Pushimin e gjykimit për kundër-padinë e paraqitur nga i padituri kundër-paditës Y.R dhe palë paditëse kundër-paditur E.R.-Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë. -Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë brenda 5 ditëve, në Gjykatën e Apelit Tiranë, afat ky që fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. U shpall sot më datë 17.05.2021 Tiranë.				
16	Shoqëria "V" sh.p.k. kundër M.B	Nr. 1359, dt 11.01.2019	Nr 818, 10.02.2020	VENDOSI: - Pushimin e gjykimit të çështjes civile Nr.1359 Akti, datë regjistrimi 11.01.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. - Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.	Nr. 2904 dt. 08. 05.2020			

				- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar të gjykatës. U shpall sot në Tiranë, më datë 10.02.2020.				
17	B.Ç kundër J.R	Nr. 12842 Dt. 23.10.2020	Në Gjykim					
18	Shoqëria "N." sh.p.k kundër Rr.L, M.B	Nr. 681, dt.21.03. 2018	Nr. 100, dt 16.01.2020	VENDOSI: • Pushimin e gjykimit të kërkesë-padisë civile me Nr. 681 regjistri themeltar. • Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse. • Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë, 5 ditor, në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit. • U shpall sot në Tiranë me datë 16.01.2020.	Nr. 2698 Dt/ 24.01.2020			
19	V..shpk , F.K kundër Media Online P....	Nr. 1360, 979; 11.01.2019	4935 dt. 08.07.2021	VENDOSI: -Pranimin e kërkesë-padisë si me poshtë: -Detyrimin e palës së paditur person fizik Xh.Z' të dëmshpërblejë palën paditëse shoqërinë V.....shpk për dëmin jopasuror/moral shkaktuar saj nga artikulli i datës 02.10.2017 në masën prej 200,000.00 lekë. -Detyrimin e palës së paditur person fizik XH.Z' të dëmshpërblejë palën paditëse F.K për dëmin jopasuror/moral shkaktuar saj nga artikulli i datës 02.10.2017 në	Nr. 2698 Dt/ 24.01.2020			

				masën prej 50,000.00 lekë. -Rrëzimin e kërkesë-padisë për pjesën tjetër. -Shpenzimet gjyqësore të padisë i ngarkohen palës së paditur në masën e padisë të pranuar nga gjykata. Ky vendim është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor. -Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve. -U shpall sot më dt.08.07.2021 në Tiranë.				
20	R.I kundër Shoqëria Tv.... sh.a , E.C	Nr, 1915, datë 03.04.2019	Nr. 4411 Dt. 23.06.2021	VENDOSI: 1. Pushimin e gjykimit të çështjes civile Nr. 1284 Akti, dt. regjistrimi 03.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; 2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse; 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. U shpall sot më dt 23.06.2021 Tiranë.				
21	A.C kundër T.V N....	Nr, 1976, 1314 datë 10.04.2019	Në Gjykim					
22	Z.D kundër E.C	Nr. 1972, 1310 dt 09.04.2019	Në Gjykim					

23	T.Ch sha, B.B kundër Qendra.I.H	Nr, 2087, 19.04.2019	Nr, 1426, datë 02.03.2020	VENDOSI: -Pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë. Detyrimin e palës së paditur, Qendra. I.H : - Të dëmshpërblejë palën paditëse, shoqëria "T.Ch" sh.a. për dëmin jopasuror, në shumën 1,000 (një mijë) euro. - Të dëmshpërblejë paditësin B.B, për dëmin jopasuror në shumën 1,000 (një mijë) euro. - Të botojë me shpenzimet e saj, vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ai të marrë formë të prerë, në një gazetë të përditshme me shpërndarjen e gjerë në treg. - Të publikojë një deklaratë përgënjeshtruese, në portalin S..... në lidhje me lajmin e datës 28.02.2019. - Urdhërohet pala e paditur, Qendra.I.H, për heqjen e lajmit të datës 28.02.2019 nga portali S..... dhe nga portalet e tjera, ku është botuar ky lajm. - Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërkimit. - Shpenzimet gjyqësore dhe ato avokatore i ngarkohen palës së paditur. - Ky vendim është i ekzekutueshëm nga shërbimi përmbarimor gjyqësor. - Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar. U shpall në Tiranë më datë 02.03.2020.				

24	R.P kundër Xh.Z,	Nr.2463, dt. 23.05.2019	Nr, 3151 dt 30.07.2020	VENDOSI: -Pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë. -Detyrimin e palës së paditur, personi fizik "P....." të dëmshpërblejë paditësin R.P për dëmin jopasuror të pësuar prej cenimit të nderit dhe personalitetit, në vlerën 100,000 (njëqindmijë) lekë. -Detyrimin e palës së paditur, personi fizik "P" të përgënjeshtrojë deklaratat e bëra në median online P..... .com duke publikuar me shpenzimet e veta vendimin e Gjykatës. -Rrëzimin e padisë ndaj të padituri Xh.Z për mungesë të legjitimimit pasiv. -Shpenzimet gjyqësore përgjysëm. Ky vendim pasi të marrë formë të prerë është titull ekzekutiv dhe i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor -Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Afati i ankimit është 15 ditë nga e nesërmja e komunikimi të vendimit të arsyetuar. - U shpall në Tiranë më 30.07.2020.	Nr/ 6298; Dt 17.02.2021			
25	K.B kundër Xh.Z	Nr. 2508, dt 28.05.2019	Nr, 5584, dt 18.12.2020	VENDOSI: -Detyrimin e palës së paditur Personi Fizik Xh.Z për të dëmshpërblyer paditësin në shumën 1.000.000 lekë, për dëmin jo pasuror të shkaktuar nga publikimi në portal in "P..... në datën 04.09.2018 të artikullit me titull "Pendohet në Gjermani A.C ,nxjerr dy emra biznesmenësh shqiptar".				

				-Detyrimin e të paditurit të publikojnë përgënjeshtrimin e artikullit në të njëjtën formë dhe mënyrë të përdorur me publikimin e tij dhe transmetimin e informacionit të rremë në portalin "P....".al, dhe duke fshirë njëkohësisht nga arkivi i portalit të sipërpërmendur artikullin shpifës. -Detyrimin e palës së paditur të paguajë shpenzimet gjyqësore dhe avokatore.				
26	E.H dhe A.T kundër A.P (person fizik)	Nr. 2635, datë 10.06.2019	Në Gjykim					
27	E.H dhe A.T kundër A.K (person fizik) (L....Media)	Nr. 2636, dt . 10.06.2019	Nr. 1297 Dt. 03.03.2021	VENDOSI: -Pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë. -Detyrimin e palës së paditur "A.K"-person fizik, që të fshijë nga faqja online www.L..... artikujt me titull: (1) "Faktet/ Gruaja e shoqëruesit të B flet keq për Shqipërinë në mediat ruse dhe shkruan për portalin e këshilltarit të kryedemokratit"; (2) "FOTO/Mohoi se shkruante në tsarizm.com, ja provat se gazetarja pranë PD-së kontribuon për portalin e lidhur me rusët"; (3) "Theu rendin dhe sigurinë publike/Procedohet penalisht "idhtari" i B, i fejuari i gazetares që nxin Shqipërinë në mediat pranë PD dhe ato ruse"; -Detyrimin e palës së paditur "A.K"-person fizik, që të shpërblejnë paditësen A.T për dëmin jo-pasuror të shkaktuar asaj në masën 50. 000 (pesëdhjetë mijë) lek. -Rrëzimin e kërkesë-padisë për				

				vlerat e tjera të kërkimit të dëmit për paditësen A.T si dhe për kërkimet e tjera të objektit të saj si dhe rrëzimin e kërkesë-padisë të paditësit E.H. -Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të padituri në raport me pjesën e pranuar dhe të rrëzuar të kërkesë-padisë. -Ky vendim është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor. -Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve ndërgjyqëse. -U shpall sot më datë 03. 03. 2021 në Tiranë.				
28	E.R kundër S.A	Nr. 2744, dt.17.06.2019	Në Gjykim					
29	E.R kundër Y.R	Nr.2745, 17.06.2019	Nr. 3247 Dt. 17.05.2021	VENDOSI -Pushimin e gjykimit të çështjes civile Nr.Regj. Them.9902/2745/1659, datë regjistrimi 17.06.2019, që i përket paditësit E.R, kundër të padituri Y.R. -Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse. -Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar. U shpall sot në Tiranë, më datë 17.05.2021.				

30	C.B kundër Ç.Gj	Nr. 3197 dt. 16.07.2019	Në Gjykim					
31	M.C kundër E.H	Nr. 3364, dt. 30.07.2019	Nr. 3235 Dt. 14.05.2021	VENDOSI: Rrëzimin e kërkesë-padisë. U shpall sot në Tiranë më datë 14.05.2021	Nr. 7099 Akti, dt. 23.09.2021			
32	P.L, T.L kundër Media Online A.N.Al	Nr.3944, dt. 23.09.2019	Nr.4365, dt 16.10.2020	VENDOSI: -Pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë. -Detyrimin e palës së paditur Media online A.N, person fizik të dëmshpërblejë paditësin T.L në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë dhe paditësen P.L në shumën 300.000 (treqind mijë) lekë për dëmin jo pasuror shkaktuar atyre. -Detyrimin e palës së paditur Media online A.N, person fizik të publikojë një përgënjeshtrim për njoftimin e publikuar prej tyre në datë 10.01.2019 për paditësin T.L. -Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur. -Ky vendim është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor, sapo të marrë formë të prerë. -Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar . -U shpall në Tiranë datë 16.10.2020.	E ankimuar			

33	T.D kundër T.... sh.a	Nr, 4400, dt.15.10.2019	Nr.4713, dt. 29.10.2020	VENDOSI: - Pushimin e gjykimit të çështjes civile me Nr.4400 Akti . - Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen paditësit. - Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë brenda 5 ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, afat ky që fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. - U shpall sot në Tiranë me datë 29.10.2020 .	Nr. 3421 Akti, dt. 25.02.2021			
34	A.A, B.A, E.A, H.A, Z.A kundër Tv. K... sh.a	Nr. 4449, dt. 17.10.2019	Nr.2845, dt. 21.07.2020	VENDOSI: Pushimin e gjykimit të çështjes civile me Nr. 4449 Regj.Them, datë 17.10.2019 regjistrimi që i përket palës paditëse E.A; B.A; H.A; Z.A, A.A me të paditur: Televizioni Kombëtar TV K.. sha Me objekt: Deklarimin e të paditurit "Tv K....." Sh.A si përgjegjës për shkaktimin e dëmit ndaj paditësve, si rezultat i publikimit në mënyrë të paligjshme të videos të transmentuar më datë 18.01.2017 në emisionin investigativ "X" prej palës së paditur. Detyrimin e të paditurit "Tv K...." Sh.a për ti paguar paditësve shpërblimin e dëmit jo pasuror të shkaktuar nga pala e paditur në vlerën prej 3.500.000 (tremilion e pesëqind) lek. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. U shpall sot më datë 21.07.2020.	Nr.3215 Akti, dt. 18. 01.2021			

35	K.K kundër Person Fizik G.C , Personi Fizik M.B; Shoqeria Tregtare Sh..... .com sh.p.k , Shoqëria Tregtare D... sh.p.k , Shoqëria Tregtare M.G.C sh.p.k , Shoqëria Tregtare F.M.N sh.a	Nr.5690 dt. 12.12.2019	Nr. 558, dt. 31.01.2020	VENDOSI: -Pushimin e gjykimit të padisë me Nr.5690 akti datë 12.12.2019. -Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen paditëses. -Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. - U shpall sot me datë 31.01.2020, Tiranë.				
36	E.K kundër Portali N. (A.B)	Nr.6401, dt. 15.01.2020	Nr. 5827 Dt. 14.09.2021	VENDOSI: -Pushimin e gjykimit. -Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë. -Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. U shpall sot me datë 14.09.2021, Tiranë.				
37	E.K kundër M.G.C shpk(Portali P.....)	Nr. 6458, dt. 15.01.2020	Nr. 4165 Dt. 15.06.2021	VENDOSI: -Pushimin e gjykimit të çështjes civile Nr.3253 akti datë 15.01.2020. -Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë. -Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë afat që fillon nga njoftimi i vendimit të arsyetuar. - U shpall sot më datë 15.06.2021, Tiranë.				

38	K.K kundër M.B	Nr. 6629, dt.17.01.2020	Nr. 555, dt. 31.01.2020	VENDOSI: 1- Kthimin e padisë dhe akteve në lidhje me çështjen Nr. 6629 datë 17.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. 2- Shpenzimet gjyqësore siç janë kryer. 3- Kundër vendimit mund të paraqitet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. 4- Ky vendim t`i njoftohet vetëm palës paditëse. U shpall në Tiranë më datë 31.01.2020				
39	K.K kundër Shoqëria Tregtare Sh.... sh.p.k	Nr. 6630, dt. 17.01.2020	Nr.883, dt. 10.02.2020	VENDOSI: - Pushimin e gjykimit të çështjes civile Nr. 6630 Regjistri Themeltar dhe datë regj. 17.01.2020. - Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse. - Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit. - U shpall në Tiranë sot më 10.02.2020.				
40	K.K kundër Shoqëria Tregëtare M.G.C sh.p.k	Nr. 631, dt. 17.01.2020	Nr.737, dt. 06.02.2020	VENDOSI: 1. Pushimin e gjykimit të çështjes civile me Nr. 6631 regj.themeltar, dt.27.01.2020, me paditëse K.K, palë të paditur shoqëria, tregtare " M.G.C" sh.p.k dhe me objekt"; Detyrimin e palëve të paditura të shpërblejnë dëmin e shkaktuar nga përhapja e lajmeve që kanë dëmtuar nderin,				

				dinjitetin, reputacionin, të drejtën e emrit dhe jetën private të paditëses K.K, duke detyruar palët e paditura të shpërblejnë palën paditëse me shumën 500.000 lekë secila prej tyre, në total në vlerën 3.000.000 leke. Detyrimin e të paditurve të fshijnë nga web-et e tyre lajmet kundrejt palës paditëse. Detyrimin e palëve të paditura të përgënjeshtrojnë lajmet e publikuara prej tyre. Detyrimin e palëve të paditura të paguajnë shpenzimet gjyqësore dhe atë avokatore. 2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse. 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve duke filluar ky afat për të dy palët nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar nga ana e kryesekretarisë. U shpall në Tiranë sot më datë 06.02.2020, ora 14.40 min.				
